



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave “Bankat dhe Tregjet Financiare”

ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë: Universiteti “Luarasi”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Dr. Drini Salko

2. Prof. Asoc. Dr. Orkida Ilollari

Korrik/2023

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Master i Shkencave Program i Integruar i Nivelit të Dytë në
“Banka dhe Tregje Financiare” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Shkolla e Lartë
Universitare Private Luarasi”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Shkolla e Lartë Universitare Private “Luarasi”
2	Njësia bazë që e ofron:	Fakulteti i Ekonomisë / Departamenti Financë-Bankë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Shkencor në “Bankat dhe Tregjet Financiare”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Nr 483 dt.12.10.2012
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	N/A
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Nr.146, dt 16.04.2021
7	Urdhër/VBA i akreditimit të parë:	Nr 95, datë, 02.11.2015
8	Cikli i studimit:	I dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 (dy) vite/4 (katër semestra)
10	Kreditet në total (ECTS):	120 Kredite
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Jo
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: “Banka dhe Tregje Financiare”	PAE & PAK 13 në total ;5 Prof. Asoc.Dr; 6 Dr; 2 Asistent lektor
18	Numri i studentëve: 2022-2023 2021-2022 2020-2021 2019-2020	17 34 30 29
19	Komente / të tjera:	N/A

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit i ciklit të dytë Master Shkencor në “Bankat dhe Tregjet Financiare” është licencuar me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr.483, datë 12.10.2012, dhe akredituar me Vendim nr.95, datë 02.11.2015. Fakulteti i Ekonomisë si njësi kryesore e këtij programi studimi përfshin tre Departamente:

1. Departamenti Financë Bankë
2. Departamenti i Administrimit të Biznesit
3. Departamenti i Ekonomiksit.

Departamenti Financë Bankë është njësia bazë e këtij programi që ka hartuar dhe propozuar këtë program studimi. Programi synon të ofrojë arsim të një niveli të lartë shkencor dhe profesional, njohuri të thelluara teorike dhe praktike si dhe trajnim për kërkim shkencor në fushën e bankave dhe tregjeve financiare. Ky program studimi është në fazën e riakreditimit.

Programi i studimit bazohet në kuadrin ligjor dhe rregullativ. Programi i studimit bazohet në Statutin e Universitetit Luarasi (UL), në Rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë, rregulloren e Departamentit të Financë Bankë dhe në vetë rregulloren e këtij programi studimi.

Ky program studimi i ciklit të dytë Master Shkencor është i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara me kreditë sipas Sistemit Evropian të Grumbullimit të Krediteve (ECTS) i shtrirë në dy vite akademike dhe në 4 (katër) semestra.

UL ka aplikuar pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për akreditimin e programit të studimit Master i Shkencave në “Bankat dhe Tregjet Financiare”, ku me shkresën Nr. 390 Prot., datë 14.11.2022 të kësaj Agjencie, ka marrë konfirmimin për aplikimin e kryer për qëllim akreditimi të këtij programi.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Përshkrim përmbledhës; (200-400 fjalë)

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, (GVJ) i përbërë nga Prof.Dr.Drini SALKO dhe Prof. As.Dr. Orkida ILOLLARI, i miratuar nga Bordi i Akreditimit dhe ASCAL, është mbështetur në këtë proces nga koordinatori teknik i ASCAL znj. Aleksandra XHAMO. GVJ përdori dokumentacionin që ka vënë në dispozicion Agjencia e Sigurimit të Cilësisë të Arsimit të lartë (ASCAL), në faqen e saj zyrtare, në dokumentacionin shtesë, të kërkuar në institucionin të administruar zyrtarisht. Burim i rëndësishëm për vlerësimin e jashtëm shërbeu Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB), i cili është rezultat i bashkëpunimit ndërmjet stafit akademik dhe atij administrativ dhe pasqyron situatën e procesit të formimit dhe të zhvillimit në Fakultetin e Ekonomisë (FE) si njësi kryesore dhe Departamentin Financë Bankë si njësi bazë e këtij program. Një rol të rëndësishëm në këtë vlerësim pati vizita në vend që u realizua pranë UL, i dhe në opinionet e shprehura nga takimet gjatë vizitës në institucion, në datat 11/05/23 dhe 12/05/23. Në bazë të agjendës së përgatitur paraprakisht dhe të dakordësuar me institucionin (UL), u realizuan takime me drejtues të njësisë kryesore/bazë e struktura të tjera të këtij institucioni, ku u verifikuan dhe u shqyrtuan edhe një sërë dokumentesh të dosjes përkatëse të aplikimit për akreditim të këtij programi.

Gjatë vizitave u kryen takime dhe intervista të shumta me hartuesit e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm(RVB), pra Grupit të vlerësimit të brendshëm (GVB), me personelin drejtues, akademik, administrativ dhe me studentët që ndjekin programin Master i Shkencave në “Bankat dhe Tregjet Financiare”.

Gjatë vizitave u krye edhe shqyrtimi fizik i të gjitha ambienteve të Universitetit të Luarasis (UL) dhe atij bazë përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave në “Bankat dhe Tregjet Financiare”.

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm (RVJ) përbëhet nga 6 standarde kryesore me kriteret e tyre përkatëse. Çdo standard është analizuar dhe vlerësuar, nëpërmjet kriterëve përkatëse.

Analiza përmban vlerësimin për çdo kriter të secilit standard, duke vlerësuar të dhënat e deklaruara në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) të përgatitur nga institucioni, evidencat për çdo standard dhe kriter përkatës, evidenca shtesë të kërkuara nga GVJ si dhe nga evidentimet nga vizita e GVJ-së në Institucion .

Ekspertët kanë evidentuar ndryshimet dhe kanë vlerësuar nëse ka ndryshime dhe sa këto ndryshime ndikojnë në përmbushjen e standardeve që lidhen me kriteret specifike.

Për secilin standard dhe kriter përkatës, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) është përgjegjës konkretisht nëse plotësohet apo jo dhe për shkallën e vlerësimit si dhe një koment në fund të çdo kriteri për të 6 (gjashtë) standardet.

Raporti përmbillet me një analizë përmbledhëse të anëve të forta dhe të dobëta lidhur me programin e studimit: Master Shkencor në “Bankat dhe Tregjet Financiare”.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) u prit mjaft mirë nga personeli akademik dhe administrativ i institucionit dhe i falënderon përzemësisht të gjithë për bashkëpunimin e plotë dhe transparent gjatë gjithë këtij procesi shumë të rëndësishëm.

SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr 95, datë 02/11/2015 janë:

- a) Të rritet numri i pedagogëve me grada dhe tituj shkencorë në funksion të këtij program studimi dhe procesi rekrutimi të parashikojë kriteret specifike për staf të specializuar në fushën e bankave dhe tregjeve financiare.
- b) Të garantojë dhe të vërtetojë stabilitetin në vijimësi të stafit akademik efektiv.
- c) Të rrisë numrin e titujve, botimeve dhe teksteve në funksion dhe në shërbim të këtij programi studimi.

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

- **Përsa i përket rekomandimit I.a):**

Në vitin akademik aktual UL ka angazhuar në Programin e Studimit të Masterit Shkencor “Banka dhe Tregje Financiare” 6 PAE dhe 7 PAK (5 Prof. Asoc.Dr ;6 Dr; 2 Asistentë lektor’), ndërsa në Departamentin e Financë-Bankë janë angazhuar 7 PAE dhe 11 PAK (4 Prof. Asoc.Dr; 6 Dr; 7 MSc).

- **Përsa i përket rekomandimit I.b):**

UL ka marrë angazhim për vijimësi të personelit akademik efektiv (PAE), gjatë 5 (pesë) viteve të fundit vihet re një qëndrueshmëri të PAE edhe pse u vu re që dekani i Fakultetit të Ekonomisë ishte larguar një muaj përpara se të vinte në institucion GVJ. Nga ana tjetër institucioni duhet të rrisë angazhimin në mësimdhënie të PAE të angazhuar në këtë program studimi për të realizuar mbi 70 % të ngarkesës mësimore pasi treguesi aktual është në nivelin 60 %. GVJ gjykon se ky rekomandim është plotësuar pjesërisht.

- **Përsa i përket rekomandimit I.c):**

GVJ gjykon që është plotësuar pjesërisht pasi, Departamenti i Financë-Bankë nga ku edhe buron programi i studimit master shkencor “Bankat dhe Tregjet Financiare”, duhet të rrisë fondin e botimeve dhe artikujve në funksion të këtij program studimi.

LISTA E SHKURTIMEVE

ASCAL	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë
DFB	Departamenti i Financë Bankë
FE	Fakulteti i Ekonomisë
IAL	Institucion i Arsimit të Lartë
GVB	Grupi i Vlerësimit të Brendshëm
GVJ	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm
NJSBC	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
RVB	Raport i Vlerësimit të Brendshëm
UL	Universiteti Luarasi
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ZKA	Zyra e Karrierës dhe Alumni
ZBNJ	Zyra e Burimeve Njerëzore

Më datë 22.06.2023, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 33/16 Prot., datë 22.06.2023, dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, përmes AMS, më datë 21.07.2023, dhe me shkresë zyrtare Nr. 38/3 Prot., datë 21.07.2023, institucioni ka dërguar komente mbi draft raportin.

GVJ pasi u njoh me komentet e institucionit mbi draft raportin, sqaron si vijon:

1. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin II.1.Kriteri 1 , GVJ arsyeton se pavarësisht rregullimeve që do të bëhen në program në vitin akademik të ardhshëm 2023-2024 vlerësimi ynë i referohet periudhës deri në fillim të këtij procesi duke evidentuar situatën aktuale. Si rrjedhojë vlerësimet tona qëndrojnë dhe **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**
2. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin II.1.Kriteri 2, GVJ arsyeton se pavarësisht rregullimeve që do të bëhen në program në vitin akademik të ardhshëm 2023-2024 vlerësimi ynë i referohet periudhës deri në fillim të këtij procesi duke evidentuar situatën aktuale. Si rrjedhojë vlerësimet tona qëndrojnë dhe **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**
3. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin II.1.Kriteri 3, GVJ arsyeton se pavarësisht rregullimeve që do të bëhen në program në vitin akademik të ardhshëm 2023-2024 vlerësimi ynë i referohet periudhës deri në fillim të këtij procesi duke evidentuar situatën aktuale. Si rrjedhojë vlerësimet tona qëndrojnë dhe **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**
4. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin II.2.Kriteri,3 GVJ arsyeton se pavarësisht rregullimeve që do të bëhen në programin e praktikës në të ardhmen vlerësimi ynë i referohet periudhës deri në fillim të këtij procesi duke evidentuar situatën aktuale. Si rrjedhojë vlerësimet tona qëndrojnë dhe **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**
5. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin II.7.Kriteri 2, GVJ arsyeton se pavarësisht rregullimeve që do të bëhen në program në vitin akademik të ardhshëm 2023-2024 vlerësimi ynë i referohet periudhës deri në fillim të këtij procesi duke evidentuar situatën aktuale. Si rrjedhojë vlerësimet tona qëndrojnë dhe **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**
6. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin IV.1. Kriteri 2, GVJ arsyeton se pavarësisht rregullimeve që do të bëhen në plotësimin me PAE në vitin akademik të ardhshëm 2023-2024 vlerësimi ynë i referohet vlerësimit deri në fillim të këtij procesi duke evidentuar situatën aktuale. Si rrjedhojë vlerësimet tona qëndrojnë dhe **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**
7. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin IV.3. Kriteri 2, GVJ arsyeton se pavarësisht propozimeve nga departamenti si njësi bazë e këtij programi për shtim të fondit të bibliotekës vlerësimi ynë i referohet periudhës deri në fillim të këtij procesi duke evidentuar situatën aktuale. Si rrjedhojë vlerësimet tona qëndrojnë dhe **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

8. Lidhur me komentën e institucionit për Standardin VI.1. Kriteri 4 GVJ arsyeton se mungon analiza e plotë dhe me vehte e procesit të ecurisë së programit të studimit dhe nuk u evidentua promovim i shembujve pozitive dhe i praktikave të mira të mësimdhënies dhe **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**
9. Lidhur me komentën e institucionit për Standardin VI.3, Kriteri. 4. GVJ arsyeton se megjithëse angazhimin serioz të institucionit për përmirësimin e cilësisë nëpërmjet strukturave të posaçme të ngritura nuk u evidentua një raport analize të rezultateve mbi dobësitë apo të metat në këtë program dhe **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave Program në “Bankat dhe Tregjet Financiare”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteret Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Referuar, rregullores të Universitetit Luarasi (UL), rregullores së Fakultetit të Ekonomisë evidenca 1.1, kreu V neni 29 si dhe Rregullores së Programit të studimit, Master i Shkencave në “Bankat dhe Tregjet Financiare” kreu II, neni 21/a, u konstatua se programet e studimit të UL-së nuk bien ndesh me interesat kombëtare, kjo për shkak të natyrës specifike shkencore të programeve të ndryshme të ofruara. Kjo vlen edhe për programin e studimit Masterin e Shkencave në “Bankat dhe Tregjet Financiare”. Ky program synon të përgatisë profesionistë në fushën e bankave dhe tregjeve financiare. Programet e studimit të Universitetit Luarasi mbështeten në aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse. <i>Evidencë nr.1.1.Rregullore e Fakultetit Ekonomik</i> <i>Evidencë nr.1.2.Rregullore e Departamentit Financë Bankë</i> <i>Evidencë nr.1.3.Rregullore e UL</i> <i>Evidencë nr,1,4. Statuti i UL</i> <i>Evidencë nr.3. Rregullore e programit MSH ne Bankat dhe Tregjet Financiare</i> <i>Evidencë nr. 5.1. Plani strategjik i zhvillimit 2021-2025</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Referuar në evidencën 1.4, Statutit të Universitetit Luarasi, neni 3, u evidentua se misioni i UL-së, lidhet, midis të tjerash, me zhvillimin e dijeve përmes mësimit dhe kërkimit shkencor. Misioni i Programit të Studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Bankat dhe Tregjet Financiare” është përgatitja e specialistëve me njohuritë bashkëkohore në këtë fushë. <i>Evidencë nr.1.1.Rregullore e Fakultetit Ekonomik</i> <i>Evidencë nr.1.2.Rregullore e Departamentit Finance Banke</i> <i>Evidencë nr.1.3.Rregullore e UL</i> <i>Evidencë nr,1,4. Statuti i UL</i> <i>Evidencë nr.3. Rregullore e programit MSH në Bankat dhe Tregjet Financiare</i>

	<i>Evidencë nr. 5.1. Plani strategjik i zhvillimit 2021-2025</i>			
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike të Institucionit.	<p>Programi i Studimit të ciklit të dytë master i shkencave në “Bankat dhe Tregjet Financiare” bazuar në Statutin e UL, Rregulloren e UL si dhe planin strategjik të saj ofrohet në përputhje me fushat e drejtimet akademike të Institucionit.</p> <p><i>Evidencë nr.1.1.Rregullore e Fakultetit Ekonomik</i> <i>Evidencë nr.1.2.Rregullore e Departamentit Financë Bankë</i> <i>Evidencë nr.1.3.Rregullore e UL</i> <i>Evidencë nr,1,4. Statuti i UL</i> <i>Evidencë nr.3. Rregullore e programit MSH në Bankat dhe Tregjet Financiare</i> <i>Evidencë nr. 5.1. Plani strategjik i zhvillimit 2021-2025</i></p>			
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	<p>Programi i studimit të ciklit të dytë master i shkencave në “Bankat dhe Tregjet Financiare” është hartuar në përputhje me strategjinë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar si dhe prirjeve globale të zhvillimit. Ky program synon të përgatisë profesionistë në fushën e bankave dhe tregjeve financiare me njohuritë sipas tendencave të tregut.</p> <p><i>Evidencë nr.1.1.Rregullore e Fakultetit Ekonomik</i> <i>Evidencë nr.1.2.Rregullore e Departamentit Finance Banke</i> <i>Evidencë nr.1.3.Rregullore e UL</i> <i>Evidencë nr,1,4. Statuti i UL</i> <i>Evidencë nr.3. Rregullore e programit MSH ne Bankat dhe Tregjet Financiare</i> <i>Evidencë nr. 5.1. Plani strategjik i zhvillimit 2021-2025</i></p>			
Konkluzione	<i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se program i studimit MSH në “Bankat dhe Tregjet Financiare” është në përputhje me misionin dhe qëllimin e veprimtarisë të UL duke ruajtur interesat dhe vlerat kombëtare.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Organizimi i UL, struktura e tij hierarkike është e ndërtuar në mënyrë të tillë që të përmbushë misionin dhe objektivat e përcaktuara prej tij por edhe të programit MSH në “Bankat dhe Tregjet Financiare”, duke pasur edhe përvojën, kapacitetet dhe burimet njerëzore të përshtatshme për një mision të tillë. Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Financë Bankës që mbulon këtë program studimi, arrijnë që nëpërmjet kualifikimit të

	<p>nevojshëm dhe kapaciteteve akademike që ato kanë, të realizojnë me sukses zhvillimin e programit.</p> <p>Referuar tabelës1 për stafin akademik të Fakultetit të Ekonomisë si njësi kryesore e programit të studimit rezulton se kjo njësi ka në përbërje të saj 3(tre) departamente me një numër staf akademike që gjatë 3(tre) viteve të fundit ka qënë 21 PAE dhe 31 PAK si dhe 2 personel ndihmës akademik. Rezulton se institucioni ka përvojën dhe burimet për ofrimin e një programi në fushën e studimit të “Bankave dhe Tregjeve Financiare”.</p> <p>Departamenti Financë-Bankë si njësi bazë e programit të studimit të masterit shkencor në “Bankat dhe Tregjet Financiare” bazuar në tabelën nr 1, 2 të RVB gjatë 3 viteve të fundit akademike ka pasur një numër të qëndrueshëm staf akademik që përbëhet nga: 7 PAE ; 11PAK dhe 2 Personel ndihmës akademik.</p> <p><i>Evidencë statistikore nr.1. në RVB</i> <i>Evidencë statistikore nr.2. në RVB</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Sipas evidencës 1.1 të rregullores së Fakultetit të Ekonomisë (FE), kreu V neni 25,27,28, 29 si dhe evidencës 1.2 të rregullores së departamentit Financë Bankë, kreu III neni 8,9 vihet re se ky departament ofron programe studimi në fushën e financës, si profesionale, ashtu edhe shkencore.</p> <p>Programet e studimit organizohen në dy nivele: Ciklin e Parë dhe të Dytë. Departamenti i Financë Bankë në UL, synon të sigurojë njohuri të krahasueshme me institutet analoge universitare jashtë vendit.</p> <p>Mbështetur dhe në konkluzionet e nxjerra nga raporti i vlerësimit të brendshëm (RVB), konkludojmë së programi i Masterit Shkencor në “Bankat dhe Tregjet Financiare” mban numrin 7 të kornizës europiane (dhe shqiptare) të kualifikimit.</p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Duke u bazuar në CV-të e personelit akademik efektiv dhe me kontratë të Masterit Shkencor në “Bankat dhe Tregjet Financiare”, përgjithësisht mund të konfirmohet përputhja e karrierës akademike me mësimdhënien në lëndën përkatëse, pjesë e programit të studimit. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit të Masterit Shkencor në “Bankat dhe Tregjet Financiare” është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, si dhe me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit.</p> <p><i>Evidencë nr.1.1.Rregullore e Fakultetit Ekonomik</i> <i>Evidencë nr.1.2.Rregullore e Departamentit Financë Bankë</i> <i>Evidencë nr.1.3.Rregullore e UL</i> <i>Evidencë nr,1,4. Statuti i UL</i> <i>Evidencë nr.3.Rregullore e programit MSH në Bankat dhe Tregjet Financiare</i> <i>Evidencë statistikore nr.1. në RVB</i> <i>Evidencë statistikore nr.2. në RVB</i> <i>Evidencë statistikore nr.3. në RVB</i></p>

Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.	Nuk aplikohet			
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtjshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Nuk aplikohet			
Konkluzione	<i>Për Standardin I.2 si gjetje nga GVJ është fakti se në këtë program studimi rezultojnë në 3 lëndë ku titullari ka gradën MSc.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësisve përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Mbështetur në Rregulloren e UL-së në Kreun IV dhe V si dhe në Rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë, Kreu II neni 5, Kreu III neni 6,7,8,9,10,11 si dhe në konkluzionet e nxjerra nga raporti i vlerësimit të brendshëm(RVB), theksojmë se institucioni nxit dhe motivon bashkëpunimin e ngushtë të personelit akademik, jo akademik, administrativ dhe studentëve, në përputhje me statutet e tyre, funksionet dhe përgjegjësitë, për arritjen dhe realizimin e qëllimeve institucionale. <i>Evidencë nr.1.1.Rregullore e Fakultetit Ekonomik</i> <i>Evidencë nr.1.3.Rregullore e UL</i> <i>Evidencë nr,1,4. Statuti i UL</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.	Sipas listës së bashkëpunimit ndërinstitucional të Universitetit Luarasi bazuar në tabelën 5, si dhe në konkluzionet e nxjerra nga raporti i vlerësimit të brendshëm, UL ka një sërë bashkëpunimesh me aktorë të biznesit, institucione publike dhe private, bashkëpunime ndërinstitucionale me një sërë institucionesh shtetërore dhe IAL brenda e jashtë vendit. Studentët mund të lëvizin në kuadër të projekteve të ndryshme, ku UL është palë.

<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Kryesisht, objektivat e këtyre bashkëpunimeve janë realizimi i praktikave profesionale me studentët sipas profilit, shkëmbimi i përvojave reciproke, krijimi i mundësive të punësimit të studentëve dhe në profil pas përfundimit të studimeve.</p> <p><i>Evidencë statistikore nr.5. në RVB</i> <i>Evidencë nr.22.1.Institucionet bashkëpunuese me UL</i> <i>Evidencë nr. 22.2.Raport analitik mbi marrëveshjet e bashkëpunimi 2018-2022</i></p>			
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Referuar listës së bashkëpunimit ndërinstitucional, raportit të vlerësimit të brendshëm, njësia përgjegjëse në funksion të realizimit të programit të studimit, “Bankat dhe Tregjet Financiare”, mban evidenca dhe analizon përfitimet, mbas diplomimit të brezit të parë të diplomimit për të parë edhe përfitimet.</p> <p><i>Evidencë nr.22.1.Institucionet bashkëpunuese me UL</i> <i>Evidencë nr. 22.2.Raport analitik mbi marrëveshjet e bashkëpunimi 2018-2022</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se program i studimit MSH në “Bankat dhe Tregjet Financiare” bazohet në një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh bashkëpunimi mes UL dhe institucioneve apo sipërmarrjeve të ndryshme duke mundësuar realizimin e praktikës profesionale dhe marrjen e eksperiencës nga specialiste të fushës jashtë institucionit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>
--	-------------------------------------	------------------------------------	-------------------------------------	-----------------

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1

Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Mbështetur në rregulloren e programit të studimit master i shkencave në “Bankat dhe Tregjet Financiare” neni 4, në Planet Mësimore (2022-2023), në dosjen e plotë të programit , literatura bazë dhe ndihmëse e syllabuseve të lëndëve si dhe në konkluzionet e nxjerra nga raporti i vlerësimit të brendshëm, u konstatua se programet e studimit të Masterit Shkencor në “Bankat dhe Tregjet Financiare” janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Planet dhe programet e disiplinave respektive të detajuara, të shoqëruara me kreditet përkatëse, hartohen dhe miratohen në departamente. Disiplinat mësimore dhe veprimtaritë formuese janë organizuar në 5 kategori, nga A në E.</p> <p>Kreditet për çdo lëndë mbajnë parasysh ngarkesën në orë mësimore dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti.</p> <p>Kohëzgjatja normale e Programit të studimit të Masterit Shkencor në “Bankat dhe Tregjet Financiare” është 2 vite akademike me 4 semestra gjithsej (120 kredite).</p> <p>Orët totale në auditor janë 1200. Programit të studimit të Masterit Shkencor në “Bankat dhe Tregjet Financiare” përmban lëndë tek secila me provimin përkatës.</p> <p>Në programin e studimit të Masterit Shkencor në “Bankat dhe Tregjet Financiare” janë përfshirë elementet që përbëjnë strukturën e programeve të studimit (sipas VKM-së nr. 41, datë 24.1.2018), si kreditet sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS); kontrolli i dijeve dhe instrumentet e vlerësimit, objektivat formues dhe kompetencat profesionale, veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit, kategoritë e veprimtarive formuese që karakterizojnë një program studimi, plani mësimor; kuotat e pranimit dhe grupet mësimore, programi lëndor (Syllabus-et), profilin i programit, diploma dhe suplementin.</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Në kuadër të vlerësimit të programit ne konstatojmë dhe sugjerojmë lidhur si me poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Në këndvështrimin e ekspertëve të jashtëm vëmë re se gjatë 4 viteve të fundit akademike nuk është bërë asnjë përmirësim në programin mësimor me qëllim reflektimin e zhvillimeve në tregun financiar.</i> • <i>Bazuar në planën mësimore të ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E) vëmë re se të dyja lëndët e kategorisë A (përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme) nuk e kanë këtë natyrë veprimtarie. Në këtë kategori janë lëndë të cilat duhet të ndodheshin në kategorinë B. Ndërsa në kategorinë B</i>

	<p>janë lëndë të cilat kanë përgatitje metodologjike e cila duhet të kalojë në kategorinë A.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Programi i studimit mund të përmirësohet duke rritur numrin e lëndëve në funksion të objektivit të tij si lëndë të tilla “Teknika Bankare”, “Marketingu bankar” etj apo duke hequr lëndë të karakterit të përgjithshëm siç është lënda “Kontabilitet Nacional”. • Për të rritur fleksibilitetin e programit ne mendojmë se në të duhet të futen lëndë me zgjedhje që do u japë mundësi studenteve të zgjedhin lëndë të preferuara në funksion edhe të punësimit në të ardhshëm. • Në disa nga programet e lëndëve duhet të bëhet përditësimi i literaturës pasi ende ka referime të literaturës të para 10 viteve • Përsa i përket praktikës në auditor, GVJ sugjeroi që këto orë praktike të zhvilloheshin me ekspertë nga tregu i punës dhe jo nga stafi akademik. • Në disa prej syllabuseve u vu re se nuk kishin të njëjtë formën e vlerësimit duke lënë në provimin përfundimtar 80% të vlerësimit. <p>Evidencë nr.2.7; 2.11;2.13.Planet mësimore 2019-2020;2020-2021; 2021-2022 Evidencë nr. 2.8; ;2.12; 2.14 Syllabuse 2019-2020;2020-2021;2021-2022 Evidencë statistikore nr.9. në RVB</p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>Nuk Aplikohet</p>
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë</p>	<p>Nuk Aplikohet</p>

së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.				
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Bazuar në Statutin e UL, organizimi i studimeve Kreu V, VII dhe IX, si dhe nga vizita në UL, GVJ vlerësoi se forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi i veprimtarisë akademike kërkimore shkencore realizohet në përputhje me ligjin e arsimit të lartë të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë së arsimit. <i>Evidence nr.1.4. Statuti i UL</i>			
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Bazuar në evidencën 2.13 të planeve mësimore u vu re se ato kanë përmbajtje të ngjashme në nivel, 70 për qind, si dhe kanë të njëjtën emërtesë. Fakulteti i Ekonomisë në UL, departamenti i Financë- Bankës, ofron dy programe studimi në ciklin e dytë të studimeve në financë: “Bankat dhe Tregjet Financiare” si dhe “Financë dhe Menaxhim Risku”, të cilat kanë një përmbajtje rreth 70 për qind nga lëndët përkatëse të tyre.			
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Sipas RVB-së, Universiteti Luarasi ka aplikuar në Ministrinë e Arsimit përta i përket kodit përkatës sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve për programin e studimit Master i Shkencave në “Bankat dhe Tregjet Financiare”			
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Bazuar në rregulloren e programit të studimit programi Master i Shkencave në “Bankat dhe Tregjet Financiare” nuk është program i përbashkët midis IAL-ve, jashtë apo brenda vendit por realizohet nga UL			
Konkluzione	<i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se program i studimit MSH në “Bankat dhe Tregjet Financiare” organizohet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në strukturë dhe përmbajtje. Megjithatë në funksion të përmirësimit të tij sugjerimet e mësipërme të GVJ lidhur me këtë program studimi do i konsideronim të rëndësishme në përmirësimin e tij.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Bazuar në rregulloren në Kreun IV të Fakultetit të Ekonomisë,/ Departamentit Financë Bankë dhe tabelës 1 dhe 2 të stafit akademik (PAK/PAE), vizitës në institucion, njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave në “Banka dhe Tregje Financiare” përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p> <p><i>Ndërkohë përsa i përket angazhimit të personelit akademik (PAE dhe PAK) në programin e studimit të ciklit të dytë master i shkencave në “Bankat dhe Tregjet Financiare” rezultojnë referuar tabelës 6 për vitet akademike 2019-2023, si edhe vizitës nga grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ)në UL se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Dy lëndë në vitet akademike 2019-2022 kanë titullarë personel akademik (PAE& PAK) me gradë Msc.</i> • <i>Tre lëndë për vitin akademik 2022-2023 kanë titullarë personel akademik (PAE& PAK) me gradë Msc.</i> <p><i>Evidence statistikore nr.1; 2; 6.1;6.2 dhe 6.3. në RVB</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Studentët në programin e Masterit Shkencor në “Banka dhe Tregje Financiare” kanë në dispozicion , laborator, sallë interneti, bibliotekë si dhe bibliotekë online.</p> <p>Gjithashtu bazuar në evidencat 22.3; 22.4; 22.5; evidencës shtesë Paketa e Praktikës së Studentëve (pasqyra e lëndës) e cila zhvillohet në semestrin e dytë, si edhe nga pyetjet që iu drejtuan nga GVJ studentëve u vu re se gjatë praktikës në auditor atyre u shpjegohej sesi duhet të bënin kërkimin shkencor për temën e diplomës. Shumica prej tyre ishin të punësuar dhe praktikën e kryenin edhe në vendin e tyre të punës. Ndërkohë pjesa tjetër në auditor merrte vetëm leksion sesi të vijonin me temën e diplomës.</p> <p><i>Evidencë statistikore nr.1; 2 në RVB</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>GVJ sipas vizitës në UL, evidencës 22.3 (pika 4) si dhe evidencës shtesë Paketa e Praktikës së Studentëve vuri re se njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave në “Bankat dhe Tregjet Financiare” ka caktuar një person i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në auditor si edhe për ndjekjen e praktikave në industri.</p> <p><i>Evidencë nr.22.3 Udhëzues për zhvillimin e lëndës së praktikës</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ, shpreh se për këtë kriter ka evidentuar që syllabusit që ka për praktikat nuk është në koherencë me objektivin që ka në vetvete praktika</i></p>

	në auditor për studentët. Gjithashtu në për të dy lëndët e mësipërme duhet të merren masa që të zhvillohen nga personel akademik të paktën me gradën shkencore Doktor.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	<p>Bazuar në rregulloren e Fakultetit Ekonomik, rregulloren e departamentit të Financë-Bankë, Udhëzuesit për përdorimin e strukturës së IT-Moodle tutorial, rregullores të programit të studimit, si dhe dosjes së plotë të këtij programi vihet re se, Fakulteti Ekonomik i UL, Departamenti i Financë-Bank, përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave në “Bankat dhe Tregjet Financiare” disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p> <p><i>Evidencë nr.1.1.Rregullore e Fakultetit Ekonomik</i> <i>Evidencë nr.1.2.Rregullore e Departamentit Finance Banke</i> <i>Evidencë nr.1.3.Rregullore e UL</i> <i>Evidencë nr.3. Rregullore e programit MSH në Bankat dhe Tregjet Financiare</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	<p>Sipas evidencave të planeve mësimore, rregullores së programit të studimit të studimit Master i Shkencave në “Bankat dhe Tregjet Financiare”, syllabuseve të lëndëve, përfshihen informacion për ndarjen e lëndëve në semestrale, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor si leksionet ashtu edhe seminarët, puna e pavarur, si dhe të gjithë komponentët formues të programit.</p> <p><i>Evidencë nr.2.13. Plani mësimor 2022-2023</i> <i>Evidencë nr.1.1.Rregullore e Fakultetit Ekonomik</i> <i>Evidencë nr.1.2.Rregullore e Departamentit Financë Bankë</i> <i>Evidencë nr.3. Rregullore e programit MSH në Bankat dhe Tregjet Financiare</i></p>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	<p>Bazuar në Rregulloren e Fakultetit të ekonomisë nenet 46 dhe 48, politikës së pranimit të studentëve neni 5, rregullores së programit të studimit neni 5,9 si dhe nga takimi me studentët u vu re se:</p> <p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Bankat dhe Tregjet Financiare” përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p> <p><i>Evidencë nr.2.13. Plani mësimor 2022-2023</i> <i>Evidencë nr.1.1.Rregullore e Fakultetit Ekonomik</i> <i>Evidencë nr.1.2.Rregullore e Departamentit Financë Bankë</i></p>

	<i>Evidencë nr.3. Rregullore e programit MSH në Bankat dhe Tregjet Financiare</i>			
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Shih vlerësimin e ekspertëve për Standardin II.3, kriteri 2.			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Referuar rregullores së departamentit Financë-Bankë Kreu I neni 5 (pikat 7,8) si edhe sipas takimit që GVJ kreu në UL me pedagogët që kryejnë mësim në programin e studimit të Masterit Shkencor në “Banka dhe Tregje Financiare” u shprehën se ky program është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik. Duke qënë se ky program kryhet vetëm në gjuhën shqipe, atëherë çdo dokumentacion i këtij programi arkivohet në gjuhën shqipe. <i>Evidencë nr.2.13.Plani mësimor 2022-2023</i> <i>Evidencë nr.1.1.Rregullore e Fakultetit Ekonomik</i> <i>Evidencë nr.1.2.Rregullore e Departamentit Financë Bankë</i> <i>Evidencë nr.3.Rregullore e programit MSH në Bankat dhe Tregjet Financiare</i>			
Konkluzione	<i>Përsa i përket këtij standartit II.3, GVJ shprehet se përmbushet plotësisht</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4	
Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Referuar Rregullores së programit të studimit të Masterit Shkencor në “Banka dhe Tregje Financiare” si dhe evidencës së studimit të tregut të punës, u konstatua se në këtë program , organizimi i lëndëve është bazuar në LAL 80/2015. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve të programit të studimit “Bankat dhe Tregjet Financiare” mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve. Gjithashtu bazuar edhe në tabelën nr 23, nga bashkëpunimet qe UL ka me aktorët e tregut të punës ka patur rezultat punësimi të lartë të studentëve që janë diplomuar në këtë program studimi.

	<p><i>Evidencë nr.2.13. Plani mësimor 2022-2023</i> <i>Evidencë nr.1.1.Rregullore e Fakultetit Ekonomik</i> <i>Evidencë nr.1.2.Rregullore e Departamentit Financë Bankë</i> <i>Evidencë nr.3. Rregullore e programit MSH në Bankat dhe Tregjet Financiare</i></p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Shih vlerësimin e ekspertëve për Standardin II.3, kriteri 2.</p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Mbështetur në dosjen e plotë të programit të studimit “Banka dhe Tregje Financiare”, u konstatua se, për ngritjen e këtij programi studimi dhe përmirësimin e vazhdueshëm të strukturës kurrikulare janë shfrytëzuar eksperiencia më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare. Programi në hartimin dhe zhvillimin e tij bazohet në eksperiencat bashkëkohore Evropiane të vendit, si edhe duke vlerësuar nevojat e tregut të punës. Mbështetur në strukturën e programit, në lëndët që përfshihen në të, nga raportet teorike praktike, ky program përputhet me fushën e zgjedhur që është ajo financiare e bankare.</p> <p><i>Evidencë nr.2.13. Plani mësimor 2022-2023</i> <i>Evidencë nr.1.1.Rregullore e Fakultetit Ekonomik</i> <i>Evidencë nr.1.2.Rregullore e Departamentit Financë Bankë</i> <i>Evidencë nr.3. Rregullore e programit MSH në Bankat dhe Tregjet Financiare</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Shih vlerësimin e ekspertëve për Standardin II.4, kriteri 1</p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Shih vlerësimin e ekspertëve për Standardin II.3, kriteri 5</p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton</p>	

përfitim e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Shih vlerësimin e ekspertëve për Standardin II.4, kriteri 1			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Referuar rregullores së programit të studimit, dosjes së plotë të programit të studimit “Bankat dhe Tregjet Financiare” si dhe studimit periodik mbi tregun e punës, u konstatua se ky program u jep mundësi studentëve të pozicionohen në karrierën e tyre të ardhshme. Ky program studimi synon që studentët të bëhen të aftë, si nga ana teorike, ashtu edhe nga ana profesionale. Referuar edhe çfarë GVJ i shprehu Dekanit dhe Përgjegjësit të Departamentit ishte se disa lëndë duhet të zëvendësohen me lëndë më bashkëkohore.			
Konkluzione	<i>Përsa i përket këtij standartit II.4, GVJ shprehet se përmbushet plotësisht</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	<p>Departamenti Financë Bankë si njësi bazë dhe përgjegjëse e këtij programi bazuar në marrëveshjet institucionale me aktorët e tregut të punës bën përpjekje në përmirësimin e programeve ku ajo është përgjegjëse drejtpërdrejt. Lidhur me këtë program ashtu siç edhe e kemi përmendur edhe me lart, përmirësimet kanë qënë kryesisht në kuadrin e lirisë akademike të stafit dhe në lëndët përkatëse, <i>por jo në ndryshime në program brenda kriterit 20% që përcaktojnë aktet ligjore dhe rregullative.</i> Nga diskutimi me stafin akademik që zhvillon këtë program evidentuam përmirësim në ciklet e leksioneve të lëndëve që ata mbulojnë kryesisht me trajtime aplikative të lidhura me tregun financiar dhe pasuritë e paluajtshme .</p> <p><i>Evidencë shtesë nr.2.Studim i tregut të punës Evidencë nr.2.7;2.11;2.13.Planet mësimore 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022 Evidencë nr. 2.8; ;2.12; 2.14 Syllabuse 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022 Evidencë statistikore nr.9.dhe nr.23 në RVB Vizitë e GVJ në institucion</i></p>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet	Bazuar vizitës në UL nga takimi me studentët, si edhe nga rregullorja e zyrës së studentit dhe këshillimit të karrierës rezulton se UL, nxit dhe përfshin në diskutime studentët, mban kontakte dhe konsultohet

vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit të masterit shkencor “Bankag dhe Tregjet Financiare”.			
	<i>Evidencë nr.1.1.Rregullore e Fakultetit Ekonomik</i> <i>Evidencë nr.1.2.Rregullore e Departamentit Financë Bankë</i> <i>Evidencë nr.3. Rregullore e programit MSH në Bankat dhe Tregjet Financiare</i>			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përnirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Referuar tabelës 5, së marrëveshjeve me Institucioneve bashkëpunuese, si edhe nga vizita në UL, rezulton se, njësia bazë nga ku buron programi studimit të masterit shkencor “Bankat dhe Tregjet Financiare”, përnirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit nga tregu i punës.			
	<i>Evidencë statistikore nr.5 në RVB</i>			
Konkluzione	<i>Përsa i përket këtij standartit II.5, GVJ shprehet se përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat maclhorë të institucionit.	Programi i studimit është i ndërtuar në përputhje me objektivat e institucionit. Programi i ciklit të dytë të studimit Master Shkencor “Bankat dhe Tregjet Financiare”, bazohet në Ligjin Nr 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH”, Ky program studimi sipas rregullores së programit ka si mision t’i pajisë studentët me një sistem bazë njohurish që i formon ata në fushën e financës dhe bankës.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Bazuar në listën e bashkëpunimit ndërinstitucional të UL, vihet re se UL synon zhvillimin e një bashkëpunimi akademik në fushat e edukimit, formimit teoriko-profesional, të kërkimit shkencor si edhe në fusha të tjera. Me fokus në: - Shkëmbim përvoja të stafit akademik; - Pjesëmarrje në kërkime dhe projekte të përbashkëta; -Organizim të konferencave apo simpoziumeve shkencore të përbashkëta. <i>Evidencë nr.1.1.Rregullore e Fakultetit Ekonomik</i> <i>Evidencë nr.1.2.Rregullore e Departamentit Financë Bankë</i> <i>Evidencë nr.3. Rregullore e programit MSH në Bankat dhe Tregjet Financiare</i>

Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Bazuar në manualin e NJSBC neni 8, programi i studimit Master Shkencor “Banka dhe Tregje Financiare” mundëson dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore. <i>Evidencë nr.17.1. Manuali i NJSBC</i> <i>Evidencë nr.1.1.Rregullore e Fakultetit Ekonomik</i> <i>Evidencë nr.1.2.Rregullore e Departamentit Finance Banke</i> <i>Evidencë nr.3. Rregullore e programit MSH në Bankat dhe Tregjet Financiare</i>			
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Bazuar në statutin e UL, planin financiar për menaxhimin me efektivitet të institucionit si dhe pasqyrave financiare të UL, vihet re se, për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore Departamenti Financë Bankë nuk vepron i veçuar financiarisht nga veprimtaria e UL dhe të gjitha aktivitetet e ndryshme të zhvilluara mbështeten financiarisht nga institucioni. <i>Evidencë nr.1.1.Rregullore e Fakultetit Ekonomik</i> <i>Evidencë nr.1.2.Rregullore e Departamentit Finance Banke</i> <i>Evidencë nr.3. Rregullore e programit MSH në Bankat dhe Tregjet Financiare</i>			
Konkluzione	<i>Përsa i përket këtij standartit II.6, GVJ shprehet se përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standarti II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Bazuar në evidencat përkatëse të dhënave të kërkimit shkencor, të dhënat e bashkëpunimeve shkencore në rang fakulteti si dhe nga raportin analitik të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit për realizimin e programit të masterit shkencor “Bankat dhe Tregjet Financiare”, u vu re se, njësia përgjegjëse mbështet projektet kërkimore-shkencore të reja si dhe dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Bazuar në rregulloren e departamentit të Financë-Bankë si dhe rregullores së programit të studimit MsC “Bankat dhe Tregjet Financiare”, theksojmë së njësia përgjegjëse, synon të angazhojë stafin akademik dhe studentët në projekte dhe kërkime shkencore. Ky angazhim ka nevojë të rritet më shumë. <i>Evidencë nr.1.2.Rregullore e Departamentit Finance Banke</i> <i>Evidencë nr.3. Rregullore e programit MSH ne Bankat dhe Tregjet Financiare</i>
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia	Njësia përgjegjëse në bashkëpunim me Fakultetin e Ekonomisë, ka organizuar 3 aktivitete të shkencore për fushën e programit të studimit

përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	MsC “Bankat dhe Tregjet Financiare”. GVJ rekomandoi se ky numër i aktiviteteve shkencore/konferencave duhet të rritet në vijim.			
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Referuar tabelës 5, së marrëveshjeve me Institucioneve bashkëpunuese, gjithashtu në raportin periodik analitik të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve (2019 - 2024) rezulton se, njësia bazë nga ku buron programi i studimit të masterit shkencor “Bankat dhe Tregjet Financiare”, formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar të punës.			
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Nuk Aplikohet			
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Nuk Aplikohet			
Konkluzione	GVJ shpreh se njësia përgjegjëse për këtë program studimi duhet të realizojë me tepër aktivitete shkencore duke përfshirë edhe studentët e këtij program.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk aplikohet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk aplikohet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e programit të studimit, planit mësimor, syllabuseve, u evidentua se në Fakultetin e Ekonomisë/Departamenti i Financë-Bankë, në UL format kryesore të punës mësimore janë leksionet, seminarët, detyrat e kursit, temat e diplomës.</p> <p>Në Fakultetin e Ekonomisë në UL zhvillohen gjithashtu leksione/seminare të hapura për të gjitha kategoritë e stafit akademik. Në planin mësimor orët mësimore në auditor dhe jashtë auditorit si angazhim individual i studentit janë të përcaktuar sipas të gjitha elementeve të një programi të nivelit Master i Shkencave</p> <p><i>Evidencë nr.2.7; 2.11;2.13.Planet mësimore 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022</i></p> <p><i>Evidencë nr. 2.8; ;2.12; 2.14 Syllabuse 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Në zbatim të rregullore së Fakultetit të Ekonomisë (FE) si dhe programit të studimit, theksojmë se, në programin e studimit MsC “Banka dhe Tregje Financiare”, personeli akademik dhe ndihmës akademik angazhohet në procesin mësimor duke iu përgjigjur diversitetit të studentëve dhe nevojave të tyre. Nga ana tjetër, nga takimi me studentët e këtij programi, GVJ evidentoi faktin e marrjes së mendimit të studentëve lidhur me përmirësimin e procesit të mësimdhënies për të kryer më shumë seanca seminare praktike të mësim nxënies nga studentët.</p> <p><i>Vizita në institucion e GVJ dhe takimi me stafin dhe studentët e programit.</i></p> <p><i>Evidencë nr.2.7; 2.11;2.13.Planet mësimore 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022</i></p> <p><i>Evidencë nr. 2.8; ;2.12; 2.14 Syllabuse 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Në mbështetje dhe të rregullores dhe programit të studimit të FE, theksojmë se UL organizon tavolina të rumbullakëta diskutime me pedagogët e rinj dhe ata me përvojë shumëvjeçare për didaktikën në mësimdhënie dhe mësimnxënie.</p> <p>Gjithashtu, UL ju ofron pedagogëve mundësinë e kualifikimit të mëtejshëm duke i trajnuar rreth metodave inovative të mësimdhënies.</p> <p><i>Evidencë nr.11.Udhëzues për metodat inovative të mësimdhënies</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në</p>	<p>Personeli akademik që mbulon këtë program ka eksperiencën dhe kualifikimin e duhur për një proces mësimdhënie të suksesshëm. Bazuar në CV-të e stafit akademik, vëmë re që pothuajse të gjithë kanë një</p>

<p>shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit të student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>formim akademik dhe profesional në fushën e Financës dhe Bankës dhe lëndëve që karakterizojnë drejtimet përkatëse. Nga takimi me studentët e programit u evidentua një bashkëpunim reciprok i frytshëm mes tyre dhe personelit akademik.</p> <p><i>Vizita në institucion e GVJ dhe takimi me stafin dhe studentët e programit.</i> <i>Evidencë nr.2.7; 2.11;2.13.Planet mësimore 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022</i> <i>Evidencë shtesë nr.5. CV e stafit akademik</i></p>			
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Departamenti i Finance-Bankë në bashkëpunim me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) vlerëson në mënyrë të vazhdueshme format e mësimdhënies sipas formave të vlerësimit të pedagogut nga eprori, monitorimit nga procesi mësimor si edhe vlerësimit nga vetë studentet.</p> <p>Nga vizita e GVJ në UL u konstatua se monitorimi dhe vlerësimi i aftësive mësimdhënëse të personelit akademik dhe ndihmës akademik realizohet në mënyrë periodike.</p>			
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>NJSBC përqendrohet, midis të tjerash, në zbatimin e mekanizmave për sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, vlerësim dhe përfshirjen e studentëve në procesin e të nxënies, evidentimin dhe përcjelljen e problemeve për zgjidhje. NJSBC monitoron procesin e vlerësimit të mësimdhënies, hulumton modele të ndryshme, vlerëson veprimtaritë e lidhura me vlerësimin e shërbimeve akademike dhe administrative, etj.</p> <p><i>Evidencë nr.12.1 Format raporti vlerësim pedagogu</i> <i>Evidencë nr.12.2.Formulari I vlerësimit të pedagogut nga eprori</i> <i>Evidencë nr.12.3. Raport I monitorimit të procesit mësimor</i> <i>Evidencë nr.17.1.Manuali I NJSBC</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Përsa i përket standartit III.1, GVJ shprehet se përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standartit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standarti III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<p>Në rregulloren e programit të studimit MsC “Bankat dhe Tregjet Financiare”, syllabuse të lëndëve përkatëse përshkruhen format e kontrollit të dijeve të studentëve.</p> <p>Në programet e lëndëve të programin e studimit MsC “Bankat dhe Tregjet Financiare” specifikohet për secilën lëndë mënyra e vlerësimit, pjesët përbërëse të tij me përqindjet dhe sqarimet përkatëse.</p> <p>Nga vëzhgimi i disa prej syllabuse nga GVJ u vu re se kishte ndryshime të formave të kontrollit me përqindje për lëndë të caktuara.</p> <p><i>Evidencë nr. 2.8; ;2.12; 2.14 Syllabuse 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022</i></p> <p><i>Evidencë nr.1.1.Rregullore e Fakultetit Ekonomik</i></p> <p><i>Evidencë nr.1.2.Rregullore e Departamentit Finance Banke</i></p> <p><i>Evidencë nr.3. Rregullore e programit MSH ne Bankat dhe Tregjet Financiare</i></p>			
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>Bazuar në syllabusin e pedagogëve të studimit programin e studimit MsC “Banka dhe Tregje Financiare” u konstatua se pedagogu i secilës lëndë, javën a parë të mësimit bën prezantimin e përmbajtjes së lëndës, objektivat, temat e lëndës si dhe elementët e tjerë të syllabusit.</p> <p><i>Evidencë nr. 2.8;2.12;2.14, Syllabuse 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022</i></p>			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	<p>Bazuar në syllabuset e lëndëve, u konstatua se kontrolli i dijeve realizohet gjatë procesit mësimor, kontrolli i dijeve realizohet përmes pjesëmarrjes dhe angazhimit të studentit në leksione, seminare, detyrat e kursit, provimit të ndërmjetëm si dhe atij përfundimtar.</p> <p>Në programet e lëndëve të MsC “Bankat dhe Tregjet Financiare “ specifikohet në çdo rast mënyra e vlerësimit, pjesët përbërëse të tij me përqindjet dhe sqarimet përkatëse.</p> <p><i>Evidencë nr. 2.8;2.12; 2.14 Syllabuse 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022</i></p> <p><i>Tabela statistikore nr.15. RVB</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se ky i fundit ka të plotë kuadrin rregullator,mbikëqyrës dhe procedural të vlerësimit të dijeve të studentëve gjatë procesit mësimor.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
----------	------------------------	--	--	--

<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Bazuar në rregulloren provimeve u konstatua se kontrolli i dijeve realizohet gjatë procesit mësimor, provimit të ndërmjetëm si dhe provimit përfundimtar siç janë parashikuar edhe në çdo syllabus të lëndëve. Vlerësimi final për çdo student është një mesatare e ponderuar e vlerësimeve të këtyre fazave. Mendojmë se kjo metodë vlerësimi i jep mundësi studentit të angazhohet gjatë gjithë semestrit dhe siguron një vlerësim më objektiv të angazhimit të tij në auditor dhe jashtë tij. <i>Evidencë nr. 2.8;2.12; 2.14, Syllabuse 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022</i> <i>Evidencë nr.1.1.Rregullore e Fakultetit Ekonomik</i> <i>Evidencë nr.1.2.Rregullore e Departamentit Finance Banke</i> <i>Evidencë nr.3. Rregullore e programit MSH në Bankat dhe Tregjet Financiare</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Universiteti Luarasi (UL) ka vënë në zbatim platformën “Moodle Luarasi LMS”.</p> <p><i>Evidencë shitesë 4. Manuali i Moodle</i></p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Për programin MsC “Bankat dhe Tregjet Financiare”, vlerësimet përfundimtare të lëndëve bëhen në përputhje me syllabuset të cilat janë bazuar në Vendimin nr.879, dt.18/12/19. <i>Evidencë nr. 2.8;2.12; 2.14, Syllabuse 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Referuar rregullores së programit të studimit MsC “Bankat dhe Tregjet Financiare”, studentët informohen dhe këshillohen vazhdimisht, me qëllim përmirësimin e ecures së tyre. Bazuar në rregulloren e provimeve vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me seanca rishikimi të provimeve të ndërmjetme dhe të provimeve përfundimtare me komente dhe feedback nga pedagogët. <i>Evidencë nr.13.4.Rregullore e provimeve</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e provimeve dhe të programit të studimit MsC “Bankat dhe Tregjet Financiare”, komisioni përgjegjës për provimet nuk lejojnë kopjimin në provime dhe detyra. <i>Evidencë nr.13.4.Rregullore e provimeve</i> <i>Evidencë nr.3. Rregullore e programit MSH ne Bankat dhe Tregjet Financiare</i></p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Bazuar në rregulloren institucionale, rregulloren e provimeve dhe të programit të studimit MsC “Bankat dhe Tregjet Financiare”, rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë të parashikuara në aktet rregullatore institucionale. Rezultatet paraprake të provimit brenda 5 ditëve punë pas zhvillimit të provimit. <i>Evidencë nr.13.4.Rregullore e provimeve</i> <i>Evidencë nr.3. Rregullore e programit MSH në Bankat dhe Tregjet Financiare</i></p>

<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Mbështetur në statutin e UL, rregullores së provimeve u konstatua se, rezultatet paraprake të provimeve u dërgohen sekretarisë si dhe dita dhe ora e përcaktuar që të bëhen rishikimet e provimeve me studentët dhe stafin akademik përgjegjës. Kur ky proces përfundon, stafi akademik i këtij programi studimi i dërgon sekretarisë rezultatet finale të provimit. Në rastet e ankimimit të rezultatit sipas edhe rregullores së ankimeve studentët i drejtohen Departamentit të Financë -Bankës i cili ngre një komision Ad-Hoc për të shqyrtuar ri-vlerësimin e provimit.</p>			
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p><i>Evidencë nr.15.Rregullore e ankimimit.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se arrihet një vlerësim i drejtë i dijeve të studentëve duke respektuar konfidencialitetin, paanësinë dhe të drejtën e ankimimit nga studentet dhe zgjidhjes së saj.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.4 Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>			
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>			
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</p>	<p>Bazuar në planin mësimor, programi i studimit MsC “Bankat dhe Tregjet Financiare”, garanton thellimin e njohurive, dhe zhvillon aftësitë profesionale dhe shkencore të studentëve në fushën e bankave dhe tregjeve financiare. Mbështetur në module që ofron programi, por edhe në praktikën profesionale të përfshirë në të, ai arrin të ketë objektiv formimin teorik, profesional dhe relativisht edhe atë shkencor të studentëve.</p> <p><i>Evidencë nr.1.1.Rregullore e Fakultetit Ekonomik</i> <i>Evidencë nr.1.2.Rregullore e Departamentit Financë Bankë</i> <i>Evidencë nr.2.1.Plani mësimor I programit të studimit</i> <i>Evidencë nr.3. Rregullore e programit MSH në Bankat dhe Tregjet Financiare</i></p>			
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Referuar programit të studimit MsC “Bankat dhe Tregjet Financiare”, si dhe syllabuseve të lëndëve shikohet se zhvillohen aftësi të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p> <p>Njëkohësisht gjejnë relativisht trajtime në zhvillimin e aftësive në fushën e informacionit në trajtimin e rasteve studimore në një numër lëndësh të këtij programi</p>			

	<i>Evidencë nr.2.1.Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidencë nr.3. Rregullore e programit MSH në Bankat dhe Tregjet Financiare</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Shih vlerësimin e ekspertëve për Standardin III.2
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Shih vlerësimin e ekspertëve për Standardin III.1
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Shih vlerësimin e ekspertëve për Standardin I.3
Konkluzione	<i>Përsa i përket standartit III.4, GVJ shprehet se përmbushet plotësisht.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Referuar rregullores së Fakultetit të Ekonomisë, rregullores së diplomimit, u konstatua se në përfundim të programit të studimit MSc “Bankat dhe Tregjet Financiare”, studenti ka të drejtë të diplomohet për të fituar titullin “Master Shkencor në “Bankat dhe Tregjet Financiare”, duke mbrojtur një punim diplome. Të gjitha procedurat e posaçme lidhur me mbrojtjen e diplomës hartohen nga institucioni dhe bëhen publike për të gjithë studentët. <i>Evidencë 13.2.Rregullore e diplomimit</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Në zbatim të rregullores së Fakultetit të Ekonomisë, si dhe rregullores së diplomimit, strukturat përgjegjëse si Departamenti, Sekretaria Mësimore si dhe të gjithë pedagoget udhëheqës, janë të detyruar sipas rregullores të asistojnë studentët gjatë procesit të mbrojtjes së diplomës. <i>Evidencë 13.2.Rregullore e diplomimit</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Nuk Aplikohet
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.	Referuar rregullores së Fakultetit të Ekonomisë, të rregullores së diplomimit, u konstatua se Departamenti i Financë-Bankë përcakton listën e temave të diplomave, duke u mbështetur në fushat përkatëse të studimit. Personeli akademik pranë departamentit të Financë-Bankës kanë detyrim të mentorojnë dhe ndihmojnë secilin student që ka nevojë për tu orientuar në temat dhe fushat përkatëse. Fusha e studimit, problemi kërkimor dhe formulimi i temës, mund të përcaktohen nga vetë studentit ose / dhe në konsultim me udhëheqësin përkatës. Universiteti Luarasi, ofron të gjithë bazën materiale në funksion të zhvillimit të temës së diplomës.

Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Temat udhëhiqen nga punonjësit mësimor-shkencor të fakultetit që kanë titull ose gradë shkencore. Në përfundim të mbrojtjes finale komisioni përgjegjës vendos notën finale. Në mbështetje të Rregullores së UL, rregullores së Fakultetit të Ekonomisë dhe rregullores së departamentit të Financë-Bankës, u konstatua se punimi i diplomës mbrohet para komisionit përgjegjës. Në përfundim të çdo seance mbrojtjeje ditore, kryetari i komisionit, në prani të anëtarëve, u komunikon studentëve në grup vlerësimet për secilin. Nota përfundimtare llogaritet si mesatare e thjeshtë e të gjithë notave të anëtarëve të komisionit. <i>Evidencë 13.2.Rregullore e diplomimit</i>			
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.				
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Bazuar në formatin e diplomës së masterit shkencor në “Bankat dhe Tregjet Financiare”, rregullores së UL, rregullores së FE, rregullores së departamentit të Financë-Bankë, dhe rregullores të programit të studimit, u evidentua se në përfundim të programit të studimit, studenti pajiset me diplomën, duke fituar titullin Master Shkencor në “Bankat dhe Tregjet Financiare” Sipas RVB-së, elementet përbërëse, forma e diplomës janë sipas kërkesave të ministrisë së arsimit dhe sporteve si dhe studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. <i>Evidencë 14.1.Diploma</i> <i>Evidencë 14.2.Suplementi i diplomës</i>			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Sipas RVB, rregullores së sekretarisë mësimorë si dhe vizitës në UL u vu re se ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen. <i>Evidencë nr.13.1.Rregullore e sekretarisë mësimore</i>			
Konkluzione	<i>Përsa i përket standartit III.5, GVJ shprehet se përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes sëstandartit	Jo përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6 Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfundimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për	

realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Nuk aplikohet pasi është program studimi master shkencor			
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.				
Kriteri 3. Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.				
Konkluzione	<i>Ky kriter nuk është plotësuar nga GVJ pasi është vetëm për praktikat profesionale për program studimi të master profesional.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit	Departamenti i Financë Bankë është njësia bazë përgjegjëse që mbulon zhvillimin e këtij programi. Personeli akademik i angazhuar në zhvillimin e programit është kryesisht staf nga ky departament. Në varësi të fokusit të lëndëve të veçanta janë të angazhuar edhe personel akademik nga departamentet e tjera, të Fakultetit Ekonomik. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton që mbulimi i këtij programi që nga viti 2019-2020 është realizuar me një numër të qëndrueshëm të stafit

akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

akademik të ndarë afërsisht në raportin 50% me 50% midis PAE dhe PAK. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, të dhënat për stafin e angazhuar në mësimdhënie për programin Msc në “Bankat dhe Tregjet Financiare” për gjatë tre viteve të fundit akademike janë si më poshtë:

Kualifikimi i stafit akademik të PS	2019-2020		2020-2021		2021-2022	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof. Dr	2	1	2	1	-	1
Prof. Asoc.	1	3	1	2	2	2
Dr/Phd	3		3	1	4	1
Msc.	1	1	1	1	1	2
Gjithsej	7	5	7	4	7	6

Në vitin aktual akademik 2022-2023 (pas saktësimit që u bë gjatë vizitës në institucion) janë 7 PAE nga të cilët 2 janë personel me titullin akademik Prof,Aso, 4 janë personel me gradën shkencore Doktor dhe një është personel me Master Shkencor. Numri i PAK për këtë vit është 7 anëtarë nga të cilët 4 janë personel me titullin akademik Prof,Asoc, 2 janë personel me gradën shkencore Doktor dhe 1 është personel me Master Shkencor. Bazuar në CV e stafit akademik që mbulon këtë program vërejmë se ai i plotëson kërkesat ligjore në fuqi lidhur me kualifikimin e stafit në fushën e programit të studimit. Megjithatë, mendojmë se institucioni duhet të rrisë me tej numrin e PAE si dhe brenda tij të rrisë kualifikimin akademik pasi gjatë 3 viteve të fundit janë angazhuar në realizimin e këtij programi 2 anëtarë staf akademik me MSc në një kohe që kërkesa ligjore e mësimdhënies në programet Master Shkencor e përcakton minimumi kualifikimin me gradë shkencore Doktor.

Evidencë statistikore e RVB, Tabela nr.4 dhe tabela nr.7

Evidenca shtesë nr. 5 CV e stafit akademik të angazhuar në program

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Nga verifikimi i të dhënave statistikore të RVB konstatohet se në vitin akademik aktual, PAE mbulon rreth 60 % të ngarkesës mësimore të programit ndaj 40 % që mbulon PAK.

Bazuar sa më sipër mendojmë që institucioni duhet të rrisë raportin e numrit të PAE apo të ulë ngarkesën mësimore të programit që zhvillohet nga PAK në mënyrë që të plotësohet kërkesa rregullatore që stafi akademik PAE të mbulojë të paktën 70% të ngarkesës mësimore të programit.

Evidencë statistikore e RVB, Tabela nr.4 dhe tabela nr.7

Evidenca shtesë nr. 5 CV e stafit akademik të angazhuar në program

Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë

Bazuar në RVB të institucionit si dhe në dokumentacionin e aplikimit për akreditim të programit vërejmë se gjatë viteve të fundit ka një

<p>qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>qëndrueshmëri të personelit akademik të angazhuar në këtë program . Nga verifikimi me zgjedhje që GVJ bëri pranë Zyrës se Burimeve Njerëzore evidentuam se PAE dhe PAK janë të punësuar në bazë të kontratave të punësimit ku janë përcaktuar edhe detyrimet mes palëve lidhur me kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.</p> <p><i>Evidencë 7.1 Formati i dosjes personale të stafit.</i> <i>Vizita në institucion nga GVJ.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Procedura e rekrutimit të stafit akademik dhe ndihmës bazohet në rregulloren e UL dhe udhëzimeve përkatëse në nivel institucional dhe njësie kryesore dhe ajo bazë, me konkretisht në Rregulloren e Zyrës se Burimeve Njerëzore ku janë të përcaktuar procedurat e rekrutimit të personelit akademik.</p> <p>Personeli akademik i programit të studimit Master i Shkencave në “Bankat dhe Tregjet Financiare” është përzgjedhur mbi bazën e procedurave parashikuar nga kuadri rregullator i përmendur më lart, në reflektim të ligjit të ri për arsimin e lartë në RSH. Departamenti prezanton nevojat për staf akademik, mbi bazën e ngarkesës mësimore dhe numrin e studentëve të planifikuar, harton kriteret referuese dhe pasi miratohen nga Fakulteti, publikohen në faqen e internetit të institucionit dhe mediat audiovizive e të shkruara. Çdo kandidaturë për pozicionet e hapura vlerësohet nga një Komision, i cili përbëhet nga drejtues të Rektoratit, Fakultetit, Departamentit dhe titullarit të lëndës që do japë mësim.</p> <p>Zyra ka ndjekur procedurat për rekrutimin e personelit, ku kriteret i përcakton Departamenti përkatës, në vijim priten aplikimet, kontrollohen nga personeli përgjegjës dhe procedohen për interviste. ZBNJ është pjesë e të gjitha hallkave të procesit të rekrutimit dhe ndjekjes së progresit të stafit, duke siguruar transparencën dhe përmbushjen e kërkesave ligjore dhe institucionale.</p> <p>Nga përzgjedhja e 2 dosjeve të stafit të programit gjatë vizitës në institucion, rezultoi se në dosjet e përzgjedhura në mënyrë rastësore, gjendet dokumentacioni si: kontrata e punës, diploma dhe lista e notave të noterizuara të studimeve universitare, masterit, doktorata, CV, etj. Gjithashtu, në dosjet e stafit akademik, ka edhe të dhëna lidhur me kualifikimet, pjesëmarrjen në veprimtari kërkimore dhe akademike, brenda dhe jashtë vendit.</p> <p><i>Evidenca nr.1.1.Rregullore e Fakultetit Ekonomik</i> <i>Evidencë nr.13. Rregullore e UL</i> <i>Evidencë nr.7. Rregullore e Zyrës së Burimeve Njerëzore</i> <i>Vizita në institucion nga GVJ.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të</p>	<p>Departamenti Financë Bankë përgjegjës për këtë program studimi ka në strukturën e tij të përfshirë 2 punonjës ndihmës akademik në shërbim të mbarëvajtjes së procesit mësimor. Gjithashtu pranë laboratorëve apo</p>

<p>përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>mjediseve të tjera në dispozicion të studentëve janë të angazhuar personel ndihmës akademik që në varësi të zhvillimit të procesit mësimor ndihmojnë në realizimin më të mirë të tij. Këtë e verifikoi edhe GVJ gjatë vizitës në institucion.</p> <p><i>Evidencë statistikore e RVB, Tabela nr.2</i> <i>Vizita në institucion nga GVJ.</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur për aplikim si dhe nga verifikimi i GVJ-së pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore evidentohet një praktikë e plotë lidhur me përditësimin e të dhënave për personelin akademik të angazhuar në këtë program. Në dosjet përkatëse të shqyrtuara me zgjedhje nga GVJ evidentohet rifreskim i përvitshëm i informacionit mbi stafin akademik me një format dosjesh personale të stafit të standardizuara në mbështetje të rregullores përkatëse.</p> <p><i>Evidencë nr.7.Rregullore e Zyrës së Burimeve Njerëzore</i> <i>Evidencë nr.7.1 Formati i dosjes personale të stafit</i> <i>Evidencë statistikore e RVB, Tabela nr.2</i> <i>Vizita në institucion nga GVJ.</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>UL ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me përfaqësues biznesi dhe kompani edhe në funksion të realizimit të praktikës profesionale për studentët. Stafi akademik që mbulon këtë program është angazhuar në ndjekjen e procesit të praktikës profesionale të studentëve pranë këtyre institucioneve. Realizimi i praktikës profesionale si komponent i rëndësishëm i programit të studimit bazohet në udhëzuesin përkatës të hartuar nga institucioni.</p> <p>Nga vizita në institucion, në takimin me stafin që mbulon këtë program, por edhe me studentët e këtij programi GVJ evidentoi që anëtarë të stafit janë caktuar për të ndjekur si praktikën e studentëve të këtij viti akademik që tashmë e kishin përfunduar, ashtu edhe si drejtues për punimin e diplomës.</p> <p><i>Evidencë statistikore e RVB Tabela nr.5.Institucionet dhe organizatat bashkëpunuese</i> <i>Evidencë.nr.13.2.Rregullore e diplomimit</i> <i>Evidencë nr.22.3.Udhëzues për zhvillimin e praktikës</i> <i>Vizita në institucion nga GVJ.</i></p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përbushjen e</p>	<p>Nga takimin me stafin e programit si dhe me studentët e këtij programi evidentuam rolin e pedagoqeve në monitorimin e praktikës profesionale si dhe në ndihmën e dhënë në hartimin e raportit që studenti dorëzon në fund të këtij procesi.</p>

detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	<i>Evidencë nr.22.3.Udhezues për zhvillimin e praktikës</i> <i>Evidencë nr.22.4.Formulari i miratimit të praktikës mësimore</i> <i>Vizita në institucion nga GVJ.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se edhe pse numri i stafit akademik i angazhuar në këtë program ka qenë i qëndrueshëm , institucioni duhet të bëjë përpjekje paralele që krahas rritjes së numrit të PAE të plotësojë edhe realizimin e ngarkesës mësimore në masën mbi 70 % nga ky personel. Gjithashtu i gjithë stafi akademik i angazhuar në këtë program duhet të zotërojë tituj akademik dhe grada shkencore si kërkesë për mësimdhënie në një program Master Shkencor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Referuar dokumentacionit të aplikimit si dhe vizitës në institucion për infrastrukturën e UL dhe sidomos të njësisë kryesore FE dhe bazë Departamentit të Financë Bankë, GVJ konstaton se institucioni disponon salla leksionesh , auditorë për seminare të përshtatshme për realizimin me sukses të programit, ambiente mbështetëse si dhe ambiente për personelin akademik e ndihmës, në shërbim të studenteve etj. Ambiente që kryejnë funksionet mbështetëse, të tilla si: Burimet Njerëzore, Financa, Biblioteka, etj. janë të akomoduar në godinën të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për një funksionim normal të aktiviteteve të tyre. <i>Evidencë statistikore e RVB Tabela nr.16.Mjediset e Fakultetit/Njësive bazë</i> <i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion (FE të UL)</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Nga konstatimi gjatë vizitave në institucion, u vu re që ambientet janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për realizimin e programit të studimit. Këto ambiente përfshijnë salla, zyra, laboratorë. Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Financë Bankës kanë ambientet e mjaftueshme në dispozicion për të realizuar mirë këtë program. Fakulteti i Ekonomisë ofron ambiente që plotësojnë të gjitha kriteret teknike si edhe normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme referuar VKM Nr. 418, datë 10.05.2017. <i>“Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe</i>

	<p><i>degëve të tyre</i>”, sipas të cilit kërkohen 2.5 m² / student, ndërkohë që institucioni këtë tregues e ka 4.575 m² / student.</p> <p>Në këto ambiente është i instaluar shërbimi Office 365 që bën të mundur përdorimin e aplikacionit Mirosoft Office. Godina ofron akses në rrjetin LAN dhe mbulohet me plotësisht me Wi-Fee. Institucion ofron sistem online të vlerësimit të pedagoqeve në fund të çdo simetri si dhe ofron platformën e-learning ku studentët të mund të marrin informacion lidhur me materialet mësimore, njoftimet e pedagogëve dhe komunikime të tjera. UL zotëron një sistem automatik për ruajtjen e të dhënave të studentëve si një bazë e rëndësishme të dhënash për studentët.</p> <p><i>Evidence statistikore e RVB Tabela nr.16.Mjediset e Fakultetit/Njësive baze.</i></p> <p><i>Evidencë nr.17. të dhëna për platformat online.</i></p> <p><i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion (FE të UL)</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, ateliët apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Në funksion të mësimin dhe punëve shkencore në godinën e institucionit janë në shërbim të studentëve dhe stafit 3 laboratorë të informatikës në dispozicion të këtij programi dhe që janë të pajisur me programe informatike bashkëkohore. Këta laboratorë u shërbejnë edhe përgatitjes së punimeve të kursit apo mikrotezës, duke iu përshtatur dhe orarit të mësimin të MSH që është pasdite.</p> <p><i>Evidencë statistikore e RVB Tabela nr.16.Mjediset e Fakultetit/Njësive baze</i></p> <p><i>Evidencë nr.17. të dhëna për platformat online.</i></p> <p><i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion (FE të UL)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Programet e instaluar në kompjuterët e laboratorëve janë bashkëkohore dhe në to janë instaluar krahas programeve bazë edhe programe të lidhura me lëndë të këtij programi siç është Ekonometria, që përdor modelimet të ndryshme.</p> <p><i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion (FE të UL)</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni</p>	<p>Me kapacitetet infrastrukturore në dispozicion, institucioni garanton mbarëvajtjen e mësimin dhe kërkimit shkencor të programit. Gjithashtu, në kuadër të marrëveshjeve që institucioni ka me institucione dhe subjekte private sigurohet edhe plotësimi i realizimit të praktikës profesionale si komponent i rëndësishëm e programit të vitit të dytë.</p>

duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorore me kapacitetet e nevojshme.	<i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion (FE të UL)</i> <i>Evidencë statistikore e RVB Tabela nr.5. Institucionet bashkëpunuese</i>			
Konkluzione	<i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se mjediset mësimore dhe infrastruktura e ofruar në funksion të zhvillimit të programit janë të përshtatshme për një zhvillim normal të tij.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Bazuar në dokumentacionin e aplikimit nga institucioni si dhe në vizitën që GVJ realizoi në ambientet e bibliotekës së UL evidentojmë që për modulet/ lëndët e programit studenteve u ofrohet përgjithësisht literatura bazë dhe ndihmëse siç edhe janë të përcaktuara në syllabuset përkatëse fizike dhe digjitale. Në mbështetje të procesit të mësim nxënies studentët kanë akses në sistemin Luarasi-Moodle LMS për literaturën përkatëse (moodle.luarasi.edu.al si dhe ne Microsoft Teams). <i>Megjithatë, mendojmë se numri i titujve të librave në shqip dhe gjuhë të huaj në funksion të këtij programi duhet të jetë më i lartë me qëllim që të shtohet me tej fondi i bibliotekës.</i> <i>Evidencë shtesë: Literatura në Moodle</i> <i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion (FE të UL)</i> <i>Evidencë statistikore e RVB Tabela nr. 17, të dhëna për platformat online</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Bazuar në dokumentacionin e aplikimit nga institucioni si dhe në vizitën që GVJ kreu pranë bibliotekës <i>konstatojmë se për disa module të këtij programi mungojnë literatura bashkëkohore në shqip dhe anglisht.</i> Nga kontaktet që patëm me drejtues të Fakultetit të Ekonomisë dhe Departamentit të Financë Bankë lidhur me këtë konstatim evidentuam që prej tyre është bërë kërkesë për të pasuruar fondin e bibliotekës me disa tekste bashkëkohore që përdoren në këtë program. <i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion (FE të UL)</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Bazuar në dokumentacion dhe vizitën në FE të UL, u konstatua se në dispozicion të studentëve të programit vihet edhe Biblioteka mësimore e vendosur në godinën ku zhvillohet mësimi. Në mjediset e kësaj Biblioteke studentët kanë mundësi të barabarta për të marrë shërbime si për të studiuar ashtu edhe për të shfrytëzuar literaturën që ofrohet. Orari dhe shërbimi i ofruar është në funksion të nevojave të studentëve. Mjediset e Bibliotekave janë të hapura edhe në fundjavë. <i>Megjithatë ,</i>

	<p><i>mendojmë se ambientet e bibliotekës për poste studimi për studentët duhet të jenë më të bollshme. Kjo bibliotekë ofron mundësinë e kërkimit dhe gjetjes së librave online në sallën e leximit nëpërmjet kompjuterëve të vendosur për këtë qëllim.</i></p> <p><i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion (FE të UL)</i> <i>Evidencë statistikore e RVB Tabela nr.17. të dhëna për platformat online</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në institucion rezulton se Biblioteka është relativisht e pajisur me literaturë fizike në shqip dhe anglisht, që përfshijnë tekste mësimore, libra, revista periodike/ buletine të institucioneve punime mikroteze dhe doktorate etj. Shërbimi në bibliotekë mbulohet nga punonjës të caktuar dhe ofrohet në dy ambientet e veçuara por pranë njeri tjetrit, në vendin e tërheqjes së librave dhe sallën periodikut. <i>Ashtu siç edhe kemi theksuar me lart ky fond duhet të pasurohet më tej me literaturë bashkëkohore.</i></p> <p><i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion (FE të UL)</i> <i>Evidencë statistikore e RVB Tabela nr.17. të dhëna për platformat online</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Shërbimet aktuale që ofron biblioteka u ofrojnë akses të barabartë përdoruesve potencial (studentëve dhe stafit akademik) dhe pa kosto pasi ata anëtarësohen pranë saj. Gjithashtu, biblioteka ofron shërbimin online me platformën digjitale të menaxhimit të librave që u mundëson përdoruesve të saj akses në baza të dhënash apo informacion të dobishëm në fushën e ekonomisë për të analizuar dhe përdorur në punime kërkimore shkencore.</p> <p><i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion (FE të UL)</i> <i>Evidencë statistikore e RVB Tabela nr.17. të dhëna për platformat online</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Ekziston një program kompjuterik i përdorur nga biblioteka për gjetjen e titujve të librave. Po ashtu kompjuterët e gjetur në bibliotekë mund të shfrytëzohen nga studentët pa kufizime. Fondi i bibliotekës është i informatizuar duke lehtësuar gjetjen e literaturës përkatëse më lehtë.</p> <p><i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion (FE të UL)</i> <i>Evidencë statistikore e RVB Tabela nr.17. të dhëna për platformat online.</i> <i>Evidencë shtesë 7. Udhëzues për përdorimin e strukturës së IT Manual: Përdorues i bibliotekës online</i></p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe</p>	<p>Biblioteka vijon me orarin 9.00 -19.00 duke ofruar shërbime edhe për studentët e të gjitha programeve një pjese e të cilave e zhvillojnë mësimin pasdite siç edhe e realizon ky program. Kompjuterët e vënë në dispozicion të stafit akademik dhe studentëve u mundësojnë që nëpërmjet platformës digjitale të menaxhimit të librit bëhet kërkimi dhe marrja e tij në kohë të shkurtër. Ky kërkim mund të bëhet edhe në ambientet e tjera jashtë bibliotekës duke përdorur këtë platforme.</p>

të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	<i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion (FE të UL)</i>			
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	GVJ bazuar në dokumentacionin e aplikimit për akreditim dhe vizitës në institutin evidenton komunikim institucional lidhur me pasurimin e fondit të bibliotekës. Evidentimit tonë për mangësi në fondin e literaturës bashkëkohore për programin, drejtuesit e Departamentit të Financë Bankë (përgjegjëse e programit) dhe dekani, na konfirmuan kërkesën e tyre për institucionin për pasurimin e këtij fondi kryesisht fizik por edhe online.			
Konkluzione	<i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion (FE të UL)</i>			
	GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se institucioni ofron mjedise të posaçme për studim dhe bibliotekë me një fond literature relativisht të pasur në funksion të procesit të mësimdhënies për stafin dhe studentët. Staf akademik dhe studentët kanë akses në bibliotekën dixhitale nëpërmjet disa platformave online për të cilat institucioni ka kontrata shërbimi. Bazuar edhe në syllabuset e lëndëve të programit institucioni duhet të pasurojë më tej fondin e bibliotekës me literaturë më të fundit si në shqip ashtu edhe në anglisht. Gjithashtu, institucioni duhet të përfshijë me shumë tekste ndërkombëtare studentësh në fushën e Financës dhe bankës të cilat tashmë një pjesë e tyre janë edhe përkthyer në gjuhën shqipe dhe janë bërë pjesë e bibliotekave të IAL në Shqipëri.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Niveli i përbushjes	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me	Administrimi i informacionit që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre mbulohet nga njësitë kryesore të UL, nëpërmjet sekretarisë mësimore, zyra e rekrutimit dhe e pranimit, zyra e karrierës etj. Për menaxhimin e informacionit për studentët , institucioni përdor sistemin e menaxhimit

<p>studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Luarasi Moodle-LSM. GVJ gjatë vizitës realizoi takime dhe monitorime pranë sekretarisë mësimore të FE të UL, ku evidentoi administrimin korrekt të informacionit për studentet që në fazën e regjistrimit të tyre deri në procesin e diplomimit. GVJ evidentoi regjistrat themeltar që mbahen për studentet e këtij programi ku bëri edhe verifikimet me zgjedhje në 4 raste, dosjet e studenteve në fillim të procesit mësimor, regjistrat e grupeve, procesverbalet e vlerësimit, hedhjen e tyre në regjistrin themeltar etj. Institucioni tashmë është në fazën e aplikimit të sistemit Pitagore në bazë të marrëveshjes që ka me RASH. Institucioni nëpërmjet faqes së tij zyrtare pasqyron informacionin me karakter akademik, administrativ kulturor e social.</p> <p><i>Evidencë nr.4.Udhëzues për përdorimin e strukturës së IT-Moodle Tutorial.</i> <i>Vizita e GVJ në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit të informacionit për personelin akademik dhe ndihmës realizohet përmes platformës “Sharepoint” e cila jep informacion mbi orarin e mësimit, ngarkesën mësimore, etikën e komunikimit etj, në bazë të hierarkisë përkatëse Personeli dhe studentët pas kërkesës së tyre kanë akses informacioni që zotërohet nga Sekretaria mësimore.</p> <p><i>Evidencë nr.4.Udhëzues për përdorimin e strukturës se IT-Moodle Tutorial.</i> <i>Vizita e GVJ në instituion</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit I përmendur me lart here pas here përditësohet me informacionin e gjithë procesit të regjistrimit, realizimit të programit dhe diplomimit të studentëve dhe bashkërendon informacionin mes pedagogut dhe studentëve. Këtu përfshihet përmbajtja e programit, procesi i mësimdhënies, materialet didaktike të pedagogut, detyrave të kursit, vlerësimin e pedagogut dhe procesit mësimor .</p> <p><i>Evidencë nr.4.Udhëzues për përdorimin e strukturës së IT-Moodle Tutorial.</i> <i>Vizita e GVJ në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Institucioni, siguron informacionin e nevojshëm krahas platformës se studentit Luarasi Moodle-LSM edhe të komunikimeve të tjera elektronike apo rrjetet sociale të njohura tashmë në tregun e informacionit të cilat janë mjete të tjera në funksion të marrjes dhe dhënies së informacionit që mbështetet me infrastrukturën e duhur. Sistemet e përmendura me lart mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit mes personelit akademik dhe ndihmës me studentët. Përdorimi elektronik përmes e-mail-it vazhdon të jetë formë kryesore e komunikimit.</p>

	<i>Evidencë nr.4.Udhëzues për përdorimin e strukturës së IT-Moodle Tutorial.</i> <i>Vizita e GVJ në institucion</i>			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Sistemi i Menaxhimit të Informacioni i bere ku përfshihen të gjitha platformat dhe mjetet e informacionit të përmendura, mundëson monitorimin dhe dhënien e informacionit të veprimtarisë administrative dhe akademike të institucionit në kohe reale. <i>Evidencë nr.4.Udhëzues për përdorimin e strukturës së IT-Moodle Tutorial.</i> <i>Vizita e GVJ në institucion</i>			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Nga konstatimi i GVJ, faqja e internetit e UL përfshin informacionin lidhur me programin dhe stafin dhe njoftime të ndryshme që kanë të bëjnë me datat e provimeve, orarin e studimeve mundësi punësimesh etj. Përveç kësaj, UL është shumë aktive edhe në rrjetet sociale dhe ne mediat audiovizive në të cilat ka informacion shtese lidhur me programin si dhe me aktivite të tjera që organizon Universiteti dhe Fakulteti i Ekonomisë. Institucioni bën përditësimin e faqes së vet të internetit të rrjeteve sociale etj. <i>Web-i i institucionit: www.luarasi-univ.edu.al</i>			
Konkluzione	<i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se sistemi i brendshëm i menaxhimit të informacionit në funksion të administrimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik plotëson standardet në shërbim të procesit mësimor, stafit akademik dhe studentëve të programit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Në dokumentet e paraqitura nga institucioni përfshihet Relacion për Planifikimin e Buxhetit Vjetor për periudhën 2021-2022, Pasqyrat Financiare si dhe Raporti i Auditit të pavarur. Shikojmë se të ardhurat e veprimtarisë janë rritur gjatë 3 viteve të fundit. Nga dokumentet e disponoheshim vihet re se burimet financiare të Institucionit janë kryesisht tarifat e studimeve në masën 98 % dhe pjesa tjetër është donacionet dhe të ardhura të tjera nga aktivitetet e tjera. Nga dokumentacioni, institucioni ka qëndrueshmëri financiare duke rezultuar me fitim dhe duke garantuar mbarëvajtjen e zhvillimit të programit në këndvështrimin financiar.

	<p><i>Evidencë nr.6.1. Relacion i Planifikimit të Buxhetit</i> <i>Evidencë nr. 6.2.Pasqyrat Financiare</i> <i>Evidencë nr.6.3. Raporti i auditit të pavarur</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në</p>	<p>Institucioni harton dokumentacionin bazë të përmendur më sipër të cilën e miraton në Senat dhe Bordin e Administrimit. Si një e tërë dokumentacion financiar evidenton qëndrueshmërinë financiare në mbarëvajtjen e programeve të studimit. Ky dokumentacion nuk hartohet në nivelin e njësisë bazë (departamentit) që mbulon këtë program. Të dhënat lidhur me tarifatat, koston për student të ardhurat etj janë në bazë institucioni për të gjithë studentët e UL (janë 1400 studentë gjithsej).</p> <p><i>Mendojmë që ne kushtet kur ka prirje të ulët numri i studentëve institucioni duhet të hartojë dokumentacionin financiar edhe në nivel të njësisë bazë e cila do saktësojë më mirë qëndrueshmërinë financiare të programit.</i></p> <p><i>Evidencë nr.6.1. Relacion i Planifikimit të Buxhetit</i> <i>Evidencë nr. 6.2.Pasqyrat Financiare</i> <i>Evidencë nr.6.3. Raporti i auditit të pavarur</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>UL si pjesë e “Hysenbelliu Grup” realizon auditim të brendshëm në kuadër të këtij grupi. Nga ana tjetër në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni është dhe Raporti i Auditorit të Pavarur për Shoqërinë UL.SH.P.K si pjesë e detyrimeve procedurale.</p> <p><i>Evidencë nr.6.3. Raporti i auditit të pavarur</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>GVJ nuk evidentoi raportim të realizimit të buxhetit në njësinë bazë lidhur me aspekte financiare për programin e studimit.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin financiar të UL shikojmë se institucioni gjatë 3 viteve të fundit ka reflektuar qëndrueshmëri financiare si në rritjen e burimeve të të ardhurave ashtu edhe në rezultatin financiar. Nga ana tjetër vazhdimi i prirjes në ulje e numrit të studentëve në të ardhmen mund të përbejë risk për qëndrueshmërinë financiare të vetë programit. Institucioni ka dëshmuar ndër vite se të ardhurat e tij janë të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e për të gjeneruar fitime.</p> <p><i>Evidencë nr.6.1. Relacion i Planifikimit të Buxhetit</i> <i>Evidencë nr. 6.2.Pasqyrat Financiare</i></p>

Konkluzione	<i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se institucioni demonstroi qëndrueshmëri financiare duke garantuar financimin dhe mbështetjen financiare për realizimin e procesit mësimor kërkimor dhe si rrjedhojë mbarëvajtjen e këtij programi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	<p>Institucioni në zbatim të akteve ligjore në fuqi, ka përcaktuar politikat dhe procedurat përkatëse lidhur me procesin e regjistrimit të studentëve, realizimit të programit të studimit dhe diplomimit të tyre. Në funksion të këtij procesi, janë një sërë aktesh rregullative të miratuara nga institucioni. Në statutin e UL në Kreun V në nenet 50, 54, 55, 60 dhe 61 janë të sanksionuara qartë dhe sakte të gjitha procedurat lidhur me programet e studimit të ciklit të dytë, procesin e shpalljes së kriterëve, dokumentacioni, rastet e transferimit të studimeve etj. Gjithashtu në zbatim të statutit të UL janë hartuar dhe 4 rregullore përkatëse në funksion të këtij qëllimi; Rregullorja e universitetit, rregullorja e Fakultetit të Ekonomisë, Rregullorja e Departamentit të Financë Bankë dhe Rregullorja e këtij programi studimi.</p> <p>Në nene të veçanta të këtyre akteve nënligjore dhe rregullative janë të përcaktuara të gjitha procedurat që shoqërojnë ecurinë e studentit në hyrje, zhvillim dhe përfundim të programit.</p> <p><i>Evidencë nr.1.3 Rregullorja e Universitetit Luarasi</i> <i>Evidencë nr.1.1. Rregullorja e Fakultetit të Ekonomisë,</i> <i>Evidencë nr.1.2.Rregullorja e Departamentit të Financë Bankë</i> <i>Evidencë nr.3. Rregullorja e Programit MSH në Bankat dhe Tregjet Financiare</i></p>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët	GVJ konstaton nga vizita në institucion, shqyrtimi i dokumentacionit dhe sidomos intervistat me studentët e programit, se politikat dhe procedurat e ndjekura nga hyrja në dalje e studentëve garantojnë

<p>për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>barazinë dhe të drejtat e tyre. Të gjitha procedurat e shoqërojnë studentin përgjatë programit.</p> <p><i>Evidencë nr.1.3 Rregullorja e Universitetit Luarasi</i> <i>Evidencë nr.1.1. Rregullorja e Fakultetit të Ekonomisë,</i> <i>Evidencë nr.1.2.Rregullorja e Departamentit të Financë Banke</i> <i>Evidencë nr.3. Rregullorja e Programit MSH ne Bankat dhe Tregjet Financiare</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Bazuar në kuadrin rregullator të përmendur më lart, GVJ konstaton se janë të përcaktuara qartë kriteret e përgjithshme për përzgjedhjen e kandidateve fitues për tu regjistruar në këtë program. Gjithashtu me propozim të Departamentit të Financë Bankës që mbulon këtë program miratohen edhe kriteret e veçanta të kandidateve aplikues duke e bërë procesin konkurrues por njëkohësisht edhe të rrisë mundësinë e prurjeve cilësore në këtë program. Vendimmarrja për fituesit merret nga organet drejtuese në bazë të relacionit të komisionit të ngritur për këtë qëllim.</p> <p><i>Evidencë nr.1.3 Rregullorja e Universitetit Luarasi</i> <i>Evidencë nr.1.1. Rregullorja e Fakultetit të Ekonomisë,</i> <i>Evidencë nr.1.2.Rregullorja e Departamentit të Financë Banke</i> <i>Evidencë nr.3. Rregullorja e Programit MSH në Bankat dhe Tregjet Financiare</i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Procedura e organizuar për pranimin është transparente për të gjithë studentët e programit të studimit Master i Shkencave në “Bankat dhe Tregjet Financiare. Studentët janë të detyruar që t’i njohin këto kriteret, të cilat janë të qarta, të kuptueshme, lehtësisht të asimilueshme, dhe të përdorshme prej kujtdo që është i interesuar. Po kështu janë lehtësisht të përdorshme dhe të kuptueshme edhe kriteret dhe procedurat e regjistrimit, të transferimit. Ato janë të bëra publike në faqen e webit të universitetit.</p> <p><i>Evidencë nr.1.3 Rregullorja e Universitetit Luarasi</i> <i>Evidencë nr.1.1. Rregullorja e Fakultetit të Ekonomisë,</i> <i>Evidencë nr.1.2.Rregullorja e Departamentit të Financë Banke</i> <i>Evidencë nr.3. Rregullorja e Programit MSH në Bankat dhe Tregjet Financiare</i> <i>Evidencë nr.18. Politikat e pranimit të studentëve</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Universiteti dhe fakulteti kanë politikat e tyre të përgjithshme të rekrutimit, por edhe politikën e tyre të pranimit të veçantë për çdo program studimi dhe për çdo vit akademik të cilat edhe në statutin e UL theksohen se mund të ndryshohen gjatë viteve. Kriteret hartohen paraprakisht në fillimin e çdo viti të ri akademik. Informacionet e nevojshme lidhur me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të studimit dhe të pranimit, janë të bëra publike edhe në faqen e internetit të universitetit: www.luarasi-univ.edu.al.</p> <p><i>Evidencë nr.1.3 Rregullorja e Universitetit Luarasi</i> <i>Evidencë nr.1.1. Rregullorja e Fakultetit të Ekonomisë,</i> <i>Evidencë nr.1.2.Rregullorja e Departamentit të Financë Banke</i> <i>Evidencë nr.3. Rregullorja e Programit MSH në Bankat dhe Tregjet Financiare</i> <i>Evidencë nr.18. Politikat e pranimit të studentëve</i></p>

Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Institucioni harton dhe publikon përpara fillimit të vitit edhe kritere specifike për kandidatë me aftësi të veçanta apo të pakicave. <i>www.luarasi-univ.edu.al.</i>			
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Ne kuadrin rregullativ të institucionit të përmendur me sipër në nenet e kriterëve të pranimit janë përcaktuar edhe kritere specifike të kandidateve nga vendet e tjera. <i>Evidencë nr.1.3 Rregullorja e Universitetit Luarasi</i> <i>Evidencë nr.1.1. Rregullorja e Fakultetit të Ekonomisë,</i> <i>Evidencë nr.1.2.Rregullorja e Departamentit të Financë Bankë</i> <i>Evidencë nr.3.Rregullorja e Programit MSH në Bankat dhe Tregjet Financiare</i>			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Nga vizita që GVJ bëri në institucion nuk u evidentua rast i mbështetjes financiare të studentëve të këtij programi studimi. <i>Vizita në institucion e GVJ</i>			
Konkluzione	<i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se institucioni ka procedurë të plotë për ndjekjen pranimit regjistrimin apo transferimin e studentëve gjatë gjithë periudhës .</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Bazuar në dokumentacionin e aplikimit pranë ASCAL-it të UL si dhe nga takimi me studentët dhe stafin akademik të programit gjatë vizitës në institucion vërejmë që studentët e regjistruar në këtë program marrin informacion të plotë lidhur me ecurinë apo progresin akademik të tyre përmes disa kanaleve të komunikimit. Informacionin e përgjithshëm studentet e marrin nëpërmjet faqes së internetit të UL në të cilat përditësohen informacionet dhe dalin njoftimet më të fundit. Po në këtë rrugë komunikimi merret informacion për orarin mësimor grafikun e provimeve datat e eventeve të tjera etj.

	<p>Informacion me specifik të modulit të programit studentet e marrin në fillim të zhvillimit të lëndës nëpërmjet titullarit përkatës në seminarin udhëzues që zhvillohet javën e parë të mësimit. Këtu njihen me syllabusin e modulit, literaturën bazë dhe ndihmesë, format e vlerësimit etj. një kanal tjetër komunikimi lidhur me mësimdhënien janë edhe përdorimi i adresave elektronike të pedagogëve dhe studentëve të cilat mund të jenë individuale por edhe adresa të grupeve mësimore (ky program ka një grup studentësh) ku informohen lidhur me vlerësimet, njoftimet për reklamim, etj. Gjithashtu, studentët marrin informacion edhe në faqen zyrtare të pedagogut përkatës. Studentet marrin informacion të përditësuar apo edhe aktual edhe nëpërmjet sekretarisë mësimore të cilës ata i drejtohen për informacionin e dëshiruar.</p> <p><i>Evidencë nr.2.14. Syllabuset e lëndëve 92022-2023</i> <i>Evidencë nr.3. Rregullorja e Programit MSH në Bankat dhe Tregjet Financiare</i> <i>Web-i i UL</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Universiteti dhe fakulteti informojnë rregullisht studentët lidhur me kriteret për njohjen e nivelit të studimeve të mëparshme, të llojit të shkollave, të nivelit të plotë apo të nivelit të pjesshëm të studimeve. UB pranon transferime të studimeve nga degë dhe fakultete ose universitete të tjera brenda vëndit dhe/ose jashtë vëndit, me kushtin që të plotësohen kreditet e parashikuara në ligjin për arsimin e lartë dhe/ose në rregulloren e shkollës dhe në statutin e universitetit</p> <p><i>Evidencë nr.3.Rregullorja e Programit MSH në Bankat dhe Tregjet Financiare</i> <i>Evidencë shitesë .10.Guida e studentëve</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Në rregulloren e këtij programi studimi të nivelit të dytë, është pjesa e vlerësimit të njohurive dhe format e vlerësimit të dijeve. Për këtë janë përcaktuar qartë procedurat, llojet e provimeve, provimet e pjesshme dhe provimet finale për secilën lëndë, mënyrat e organizimit të provimeve, format e hartimit të tezave, procedurat e miratimit të tezave në këndvështrimin administrative dhe akademik, si dhe elementë të tjerë të nevojshëm.</p> <p>Format e vlerësimit dhe koha e shlyerjes së çdo detyrimi për secilën lëndë dhe për të gjithë studentët, bëhen të qarta në orët e para të kontaktit të pedagogut në auditor me studentët dhe kjo është parashikuar edhe në syllabusat e lëndëve. Institucioni ka hartuar dhe gjuhën e sistemit Pitagora që pritet të aplikohet në institucion në bazë të marrëveshjes me RASH.</p> <p><i>Evidence nr.3. Rregullorja e Programit MSH në Bankat dhe Tregjet Financiare</i> <i>Evidencë shitesë .10 Guida e studentëve</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e</p>	<p>Krahas kuadrit rregullator të përmendur më lartë ku ka përcaktime lidhur me procesin dhe procedurën e punimit të diplomës, një rol të rëndësishëm luan edhe informimi nga pedagogët që zhvillojnë këtë</p>

punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	<p>program. Nga takimi me studentët e këtij programi të kursit të dytë u konfirmua se ata ishin njohur me kriteret dhe procedurat e përgatitjes dhe mbrojtjes së punimit të mikrotezës që në fillim të vitit të dytë si nëpërmjet udhëzuesit të institucionit, ashtu edhe nga pedagogët përkatës dhe njëkohësisht të udhëheqësit të punimeve të tyre. Gjithashtu, një informacion në këtë drejtim studentët marrin edhe nga faqja e internetit të UL.</p> <p><i>Evidencë nr.1.3 Rregullorja e Universitetit Luarasi</i> <i>Evidencë nr.1.1. Rregullorja e Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>Evidencë nr.1.2.Rregullorja e Departamentit të Financë Banke</i> <i>Evidencë nr.3. Rregullorja e Programit MSH ne Bankat dhe Tregjet Financiare</i></p>			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	<p>Krahas takimeve që zhvillon stafi akademik që në procesin e marketingut pranë shkollave të mesme informim të plotë studentet marrin që gjatë procesit të aplikimit dhe në vazhdimësi, nëpërmjet takimeve pranë zyrës së informacionit, në sekretarinë mësimore, udhëzuesit të studentëve (guides përkatëse të studentit), webit të institucionit, etj.</p> <p>Nga takimi me stafin akademik u evidentua roli i Departamentit të Financë Bankës në informimin e kandidateve potenciale për tu regjistruar në këtë program që janë studentet në diplomim të programit Bachelor në Fakultetin e Ekonomisë</p> <p><i>Evidencë nr.1.3 Rregullorja e Universitetit Luarasi</i> <i>Evidencë nr.1.1. Rregullorja e Fakultetit të Ekonomisë,</i> <i>Evidencë nr.1.2.Rregullorja e Departamentit të Financë Banke</i> <i>Evidencë nr.3.Rregullorja e Programit MSH ne Bankat dhe Tregjet Financiare</i> <i>Takimi me stafin akademik dhe studentët e programit realizuar gjatë vizitës së GVJ në institucion.</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se UB ka dokumentacion të plotë lidhur me informimin e studentëve për kriteret e pranimit, për detyrimet e tyre lidhur me programin e studimit, për rregullat dhe afatet e detyrimeve, për mbrojtjen e provimit final si dhe për kriteret e hyrjes dhe të transferimit të studimeve.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbyhet	Përmbyhet pjesërisht	Përmbyhet kryesisht	Përmbyhet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për	Para dhe gjatë periudhës së regjistrimeve institucioni ofron informacionin e rëndësishëm për studentët kandidatë dhe ata që

<p>strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>regjistrohen lidhur me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e këtij programi. Nga takimi dhe vizitat në mjediset e UL, nga takimet dhe kontaktet me studentët si dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion që mbështet raportin e vetëvlerësimit të brendshëm, konkludohet se studentët janë të mirë informuar, në mënyrë të plotë dhe në detaje, lidhur me strukturën e programit të studimeve, organizimin e studimeve dhe kohëzgjatjen e tyre, duke nënkuptuar limitet dhe hapësirat e lejuara. Format dhe mënyrat e realizimit të këtij objekti kanë qënë të ndryshme. Konkludojmë se janë përdorur si informimi i menjëhershëm dhe i pritjes dhe të vizitave të studentëve, në ditët e regjistrimit dhe të sqarimit, në takimet informuese dhe sqaruese para marrjes së vendimit përfundimtar për regjistrim.</p> <p><i>Evidencë nr.3. Rregullorja e Programit MSH në Bankat dhe Tregjet Financiare</i> <i>Evidencë shtesë .10.Guida e studenteve</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Në Rregulloren e Programit MSH ne Bankat dhe Tregjet Financiare është pasqyruar krahas informacioneve të tjera të dobishme edhe program mësimor i ndarë në lëndë/module, ngarkesë mësimore në auditor dhe jashtë tij etj. Gjithashtu studentët njihen që në fillim të mësimit me përmbajtjen e programit të lëndes përkatëse.</p> <p><i>Evidence nr.3.Rregullorja e Programit MSH në Bankat dhe Tregjet Financiare</i> <i>Evidencë shtesë .10.Guida e studentëve</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Studentët janë të mirë informuar lidhur me mundësitë e punësimit që në fillim por edhe gjatë zhvillimit të mësimit. Nga takimi me studentët e programit ne eidentuam që një numër i konsiderueshëm i studentëve janë të punësuar në sektorët e ekonomisë.</p> <p>Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim luan edhe Zyra e Këshillimit dhe Karrierës, si ajo Alumni me informacion të dobishëm për punësimin potencial të tyre.</p> <p><i>Takim i GVJ me studentët e programit</i> <i>Evidencë nr.20.2. Udhëzues nga Qendra e Karrierës dhe Alumni</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Studentët kanë akses të plotë në marrjen e informacionit përmes gjithë kanaleve të komunikimit elektronik të përmendura me lart, si dhe nëpërmjet kontakteve me stafin akademik që mbulon këtë program, drejtuesit e njësive kryesore/baze, Zyrën e Karrierës dhe sekretarinë mësimore.</p> <p><i>Takim i GVJ me studentët e programit</i> <i>Evidencë shtesë.12.Orientimi i studentëve</i></p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë</p>	<p>Sistemi i informacionit me të gjitha format e analizuara me lart është i arritshëm edhe nga studentët në distancë. Edhe nga takimi me studentët e programit, opinioni i tyre mbi lehtësinë e marrjes së informacionit ishte pozitiv</p> <p><i>Takim i GVJ me studentet e programit</i> <i>Evidence shtese.4.Udhëzues për përdorimin e platformës IT-Moodle Tutorial</i></p>

lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.									
Konkluzione	<i>UL ka format dhe mënyrat e informimit lidhur me organizimin dhe funksionimin e programit të studimeve. Për këtë studentët e programit të studimit kanë akses në rrugë elektronike dhe janë pjesë e platformës së posaçme të informimit të brendshëm.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	<p>UL ka evidence dhe statistika të plota, të azhornuara mirë, të përvitshme, me të gjitha të dhënat për numrin e studentëve të regjistruar për çdo vit akademik për këtë program studimi. Të dhënat janë në nivel vjetor, por edhe statistika që ndjekin dinamikën dhe ecurinë e progresit të secilit student në çdo detyrim dhe provim.</p> <p>Bazuar në tabelat e paraqitura në aneksin e RVB shohim që numri i studentëve të diplomuar që nga fillimi i këtij programi studimi në vitin 2017 deri 2022 është 105 të diplomuar.</p> <p><i>Evidencë. Aneks i RVB, Tabela nr.23.</i> <i>Vizita e GVJ në institucion</i></p>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	<p>UL disponon statistika për numrin e studentëve të regjistruar në këtë program studimi. Bazuar në tabelat përmbledhëse në fund të RVB dhe vizitën e GVJ në institucion në 4 vitet e fundit akademike (përfshirë dhe vitin akademik aktual) janë regjistruar 114 studentë nga të cilët vetëm 4 prej tyre janë me transferim nga universitete të tjera. Vëmë re se në vitin aktual ka një rënie të numrit të studentëve të regjistruar.</p> <p>Në këtë program studimi nuk ka pasur studentë të tërhequr nga programi i studimit. Sekretaria mësimore mban dhe ndjek në regjistra të veçanta, sipas formatit të miratuar nga Ministria e Arsimit, të dhënat e çdo studenti dhe statistikat për gjithë numrin e studentëve në këtë program studimi.</p> <p><i>Evidencë nr.13. 1.Rregullore e Sekretarisë Mësimore</i> <i>Evidencë. Aneks i RVB, Tabela nr.22.</i> <i>Vizita e GVJ në institucion</i></p>
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe	<p>Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të universitetit: regjistrave me shënime dhe dokumenteve të printuara dhe nëpërmjet të dhënave të ruajtura dhe ruajtura në rrugë elektronike. Të dhënat janë lehtësisht të kontrollueshme dhe të</p>

duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	verifikueshme prej ekspertëve të vlerësimit të jashtëm. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore GVJ evidentoi regjistrimet e studentëve në regjistrin themeltar. Institucioni po aplikon edhe sistemin Pitagora bazuar në marrëveshjen me RASH. Të dhënat janë nxjerrë nga dokumentet bazë si dhe nga procesverbalet dhe dokumentet e tjera të hartuara dhe të plotësuara konform akteve dhe rregulloreve të UL. <i>Evidencë nr.13. 1.Rregullore e Sekretarisë Mësimore</i> <i>Evidencë shtesë. Manuali i përdorimit Pitagora</i> <i>Vizita e GVJ në institucion</i>			
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Të dhënat që grumbullohen dhe përpunohen nga sekretaritë mësimore janë objekt i kontroleve periodike prej strukturave të tjera eprore, si dhe përdoren në analizën mësimore të Departamentit të Financë Bankë si njësi bazë dhe Fakultetit të Ekonomisë si njësi kryesore Këto të dhëna kryqëzohen edhe me të dhënat që përpunohen prej sistemeve të brendshme të përpunimit dhe menaxhimit. <i>Evidencë nr.13. 1.Rregullore e Sekretarisë Mësimore</i> <i>Evidencë shtesë. Manuali i përdorimit Pitagora</i>			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Nga vizita që GVJ realizon në institucion evidentuam bashkëpunimin ndërmjet Departamentit të Finance Bankë me zyrën Alumni të universitetit në shkëmbimin dhe analizën e të dhënave të studentëve të regjistruar. Në dokumentacionin e aplikimit të institucionit për 4 vitet e fundit është edhe raporti i analizës lidhur me diplomimin dhe punësimin e studentëve treguesit e të cilit janë evidentuar dhe në pasqyrat anekse të RVB. GVJ nuk evidentoi raport të analizes lidhur me studentët e programit <i>Evidencë 20.1.Rregullore e zyrës së studentit dhe këshillimit të Karrierës.</i> <i>Vizita e GVJ në institucion</i> <i>Evidencë shtesë: Raport analitik i studentëve Alumni</i>			
Konkluzione	GVJ konkludon se institucioni plotëson kriteret lidhur me evidentimin, përditësimin dhe ruajtjen e të dhënave mbi procesin e mësimdhënies që nga regjistrimi i studenteve deri në diplomimin e tyre..			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5 Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>UL, në zbatim të ligjit 80/2015 dhe të statutit dhe rregullores të tij, u garanton studentëve përfaqësim në proceset vendimmarrëse dhe këshilluese në nivel institucioni si në Senatin Akademik, Këshillin e Etikes, NJSBC, Në institucion në bazë të rregullores së UL operon dhe Këshilli Studentor që përfaqëson dhe mbron interesat e studentëve. U evidentua pjesëmarrja e studentëve në këto organe vendimmarrëse dhe pjesëmarrja e tyre në takimet që ata zhvillojnë nëpërmjet vendimeve përkatëse të ngritjes së këtyre strukturave apo gjatë operimit të tyre.</p> <p><i>Evidencë nr.1.4.Statuti i UL</i> <i>Evidencë nr.1.3.Rregullore e UL</i> <i>Evidencë nr.20.1.Rregullore e zyrës së studentit dhe këshillimit të Karrierës.</i> <i>Takime me studentë gjatë vizitës në institucion të GVJ</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dosjes se aplikimit të institucionit pranë ASCAL-it si dhe nga takimi me studentet në vizitën e GVJ në institucion evidentohet roli aktiv i studentëve apo i përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse. Gjithashtu, një rol të rëndësishëm kanë studentët nëpërmjet vlerësimit periodik që ata bëjnë për nivelin e mësimdhënies gjë e cila realizohet si nëpërmjet anketimit anonim ashtu edhe nëpërmjet diskutimeve me titullarët e lëndëve përkatëse të programit. Në RVB të programit një nga anëtarët e grupit është student.</p> <p><i>Evidencë nr.1.4.Statuti i UL</i> <i>Evidencë nr.1.3.Rregullore e UL</i> <i>Evidencë 20.1.Rregullore e zyrës së studentit dhe këshillimit të Karrierës.</i> <i>Takime me studentë gjatë vizitës në institucion të GVJ</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Përfshirja e studentëve në procesin e rishikimit dhe përmirësimit të programit realizohet kryesisht nëpërmjet vlerësimeve nga anketimet e tyre për programin dhe pedagogun e lëndës organizuar nga NJSBC. Gjithashtu ky vlerësim realizohet edhe nëpërmjet diskutimeve që bëjnë me pedagogun e lëndës.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të aplikimit si dhe nga verifikimi gjatë vizitës në institucion GVJ nuk evidentoi ndryshim në kurrikulën e programit të studimit që nga fillimi i këtij programi në vitin 2017.</p> <p><i>Evidencë 12.1.Pyetësor i studentëve online</i> <i>Evidencë 15.Rregullorja e ankimimit.</i> <i>Vizita e GVJ në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e</p>	<p>Bazuar në kuadrin rregullativ të institucionit si dhe nga takimi i GVJ me studentët e programit, evidentuam faktin se studentët janë të lirshëm të japin mendime në përmirësimin e programit si dhe kanë të drejtën e ankimimit lidhur me procesin e vlerësimit të tyre. Po ashtu edhe nga takimi me stafin akademik që zhvillon këtë program u evidentua mundësia dhe dy raste ankimimesh nga studentët të zgjidhura mes palëve.</p> <p><i>Evidencë 12.1. Pyetësor i studentëve online</i> <i>Evidencë 15.Rregullorja e ankimimit.</i></p>

institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Vizita e GVJ në institucion			
Konkluzione	Studentët janë pjesë e strukturave drejtuese të universitetit, ata e kanë të garantuar këtë prezencë, zëri i tyre institucionalisht është i pranishëm ndërsa në fakt, ata vetë ndihen pak dhe ngrenë shumë rrallë për të mos thënë aspak probleme lidhur me përmirësimet në programe. Vlerësimi i tyre është i drejtë, transparent dhe studentët kanë të gjitha hapësirat e nevojshme që të rishikojnë vlerësimin e njohurive të tyre në se në ndonjë rast konstatojnë se pritshmërinë e tyre janë larg rezultatit të arritur. Pedagogët janë të hapur dhe kanë detyrimin të organizojnë seancë sqaruese.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	UL krahas zyrës së marrëdhënieve me publikun dhe marketingun, informimin e shërbimit të studentëve e realizon kryesisht nëpërmjet një zyre të posaçme për pritjen, informimin dhe këshillimin e studentëve që është Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës. Kjo zyrë ka dhe informacion rreth studentëve në momentin e regjistrimit gjatë zhvillimit të procesit mësimor dhe punësimet e tyre pas diplomimit. <i>Evidencë 20.1.Rregullore e zyrës së studentit dhe këshillimit të Karrierës.</i> <i>Takime me përfaqësues të zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës gjatë vizitës në institucion të GVJ</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Informimi i studentëve të programit të studimit realizohet që në procesin e regjistrimit, gjatë zhvillimit të programit dhe në përfundim të diplomimit kryesisht nëpërmjet sekretarisë mësimore dhe Zyrës së Studentëve dhe këshillimit të karrierës. Gjithashtu, studentët kanë mundësi informimi mbi ecurinë e vlerësimit të procesit mësimor edhe nga anëtarë të stafit akademik që mbulojnë këtë program si dhe njësia bazë dhe kryesore e institucionit. Gjithashtu në Tetor të çdo vitit Fakulteti i Ekonomisë si njësi kryesore e programit organizon javën e orientimit të studentëve ku këta të fundit marrin informacion të hollësishëm mbi procesin mësimor, platformat që përdoren, mënyrat e vlerësimit, modeli i një programi lënde etj. <i>Evidencë 12.Orientimi i studentëve</i> <i>Evidencë 20.1.Rregullore e zyrës së studentit dhe këshillimit të Karrierës.</i> <i>Takime me përfaqësues të Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës gjatë vizitës në institucion të GVJ</i>

<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës ndjek gjithë procesin e informacionit për studentët dhe bashkëpunon edhe me struktura të tjera të institucionit në funksion të informimit sa më të plotë të studentëve . Institucioni ka të hartuar edhe paketën e praktikës profesionale në formën e modelit të një syllabusi.</p> <p><i>Evidencë shtesë: Paketa e praktikës profesionale</i> <i>Evidencë 12.Orientimi i studentëve</i> <i>Evidencë 20.1.Rregullore e zyrës së studentit dhe këshillimit të Karrierës</i> <i>Evidencë nr.20.2.Udhëzues nga Zyra e Karrierës dhe Alumni</i></p>		
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Zyra e Këshillimit të Karrierës përfshin edhe Alumnin e cila ndjek në mënyrë të vazhdueshme punësimin e studentëve gjatë dhe pas diplomimit të tyre. Kjo zyrë harton dhe raportin analitik të studentëve çdo vit akademik duke përditësuar të dhënat.</p> <p><i>Evidencë nr.20.2. Udhëzues nga Zyra e Karrierës dhe Alumni</i> <i>RVB, Anekset . Tabela nr.23</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Universiteti “Luarasi” ka zyra të posaçme që ndjekin progresin dhe programin e studimit MSH në “Bankat dhe Tregjet Financiare. Sekretaria mësimore dhe zyra e Studentore e Këshillimit dhe Karrierës janë kanalet kryesore të informimit të studentëve para, gjatë dhe pas diplomimit të tyre. Në këndvështrimin institucional progresi i studentëve dhe karriera e tyre ndiqet nga këto dy hallka të institucionit.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
--	-------------------------------------	------------------------------------	---

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

<p>Standardi VI.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>

<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Institucioni ka hartuar udhëzues strategjik për një periudhë 5 vjeçare (2019-2024) të veçantë me fokus metodat e ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Këtu paraqiten parimet bazë dhe drejtimet kryesore të zhvillimit pedagogjik dhe didaktik të stafit akademik të UL. Udhëzuesi i vë rëndësi mësimdhënies me në qendër studentin. Një dokument tjetër që GVJ shqyrtoi nga dosja e aplikimit është edhe analiza e vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies në shkollat e larta. Në këtë dokument shtjellohet vlerësimi i cilësisë mbi bazë të metodave statistikore.</p> <p><i>Evidencë nr.11.Udhëzues strategjik i metodave inovative të mësimdhënies (2019-2024)</i></p> <p><i>Evidencë nr.12.4. Analiza e vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies në shkollat e larta mbi bazën e metodave statistikore.</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Për programin e studimeve MSH në “Bankat dhe Tregjet Financiare” pranë UL ka struktura të posaçme që përgjigjen për ndjekjen dhe monitorimin, apo vlerësimin periodik të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik, cilësinë e mësimdhënies sikurse janë Zv.Rektori për mësimin që ka në varësi Zyrën e Njësisë së Sigurimit të Brendshme të Cilësisë (NJSBC), Departamenti i Financë Bankë si njësi bazë e programit, sekretaria mësimore etj. Në mënyrë periodike këto struktura bëjnë një vlerësim periodik të mësimdhënies.</p> <p><i>Evidencë 12.1.Format raport vlerësimi pedagogu</i></p> <p><i>Evidencë 12.2.Formular i vlerësimit të pedagogut</i></p> <p><i>Evidencë 12.3.Raport i monitorimit të procesit mësimor.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>UL vlerëson mendimin dhe opinionin e studentëve në lidhje me vlerësimin periodik të formave të mësimdhënies. Për këtë janë organizuar pyetësorë vlerësimi për pedagogun. Institucioni ka organizuar dy herë në vit pyetësorë me studentët, si rregull në fund të çdo semestri. Ata vlerësojnë lëndën, mësimdhënien, metodat, aplikimin dhe alternimin e metodave të transmetimit të dijeve, lidhur me literaturën dhe elementët e tjerë. Organizimi i vlerësimit nga studentet për pedagogun realizohet nga NJSBC. Ne eidentuam se kjo njësi harton një raport përmbledhës të vlerësimit të pedagogëve nga studentët.</p> <p><i>Evidencë 12.3.Raport i monitorimit të procesit mësimor.</i></p> <p><i>Evidencë shtesë: Raport nga zyra e cilësisë për vlerësimin e pedagogut</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur për aplikim institucioni ka dy struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, NJSBC në nivel institucional dhe Grupin e Vlerësimit të Brendshëm në nivel fakulteti. Nga dokumentacioni i paraqitur eidentuam raportin përmbledhës statistikor të vlerësimit në të cilin kryesisht në forme tabelore paraqiten rezultatet e anketimit të studentëve për vlerësimin e procesit mësimor.</p> <p>Mendojmë se institucioni duhet të bëjë një analizë më të thelluar të rezultateve të anketimit e cila mungon. Gjithashtu nuk eidentuam</p>

	<p>analizë me vehte të procesit të vlerësimit të mësimdhënies për programin që po vlerësojmë.</p> <p><i>Evidencë nr.17. 1. Manuali i sigurimit të cilësisë</i> <i>Evidencë shtesë. Raporti përmbledhës statistikor i vlerësimit</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe shqyrtimi dokumentacionit të aplikimit nuk evidentuam mekanizma të promovimit apo praktika të mira që të nxitin personelin akademik në përmirësimin e punës në të ardhmen.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Universiteti ka dy struktura të posaçme që ndjekin dhe garantojnë ecurinë e programit të studimit, si dhe përmirësimin e mësimdhënies. Studentët janë të përfshirë në këtë proces dhe përfshirja e tyre është e garantuar, rezultatet e mësimdhënies si rregull diskutohen në njësinë bazë, megjithë që për programin e studimit MSH në Bankat dhe Tregjet Financiare nuk ka analizë më vehte. Raporti është në formë tabelore dhe mungon analiza e të dhënave të përpunuara.</i></p> <p><i>Nuk evidentuam promovim të shembujve të mirë dhe praktikat e përmirësimit të mësimdhënies.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>UL ka hartuar dhe ndjek politika që synojnë ndjekjen dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, në përputhje me kërkesat e ligjit për arsimin e lartë dhe të akteve të tjera në fuqi, të akteve rregullatorë dhe institucionale. Janë krijuar dy strukturat në nivel universiteti, NJSBC dhe Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave, të cilat kanë gjithashtu aktet e tyre rregullative, siç janë rregulloret, dhe manuali i sigurimit të cilësisë. Gjithashtu institucioni ka të miratuar edhe strategjinë e NJSB në të cilën jepen korniza e këtij komponenti, por që në këtë dokument mungon parashikimi për drejtimet në vitet e ardhshme.</p> <p><i>Evidencë nr.17. 1. Manuali i sigurimit të cilësisë</i> <i>Evidencë nr.17.2 Strategjia e NJSBC</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të</p>	<p>Në nivel institucional janë krijuar dy strukturat; NJSBC dhe Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave. Në rang të njësisë kryesore (fakulteti i Ekonomisë është GVB.</p>

<p>Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Po kështu edhe njësia bazë, Departamenti i Financë Bankë monitoron procesin e mësimdhënies, ndjek respektimin e programeve, të vijueshmërisë, të plotësisë të javëve mësimore dhe elementëve të tjerë të parashikuar.</p> <p><i>Evidencë nr.17. 1. Manuali i sigurimit të cilësisë</i> <i>Evidencë nr.17.2 Strategjia e NJSBC</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Ka një sërë elementësh që shërbejnë për vlerësimin e cilësisë, si formularë, pyetësorë që plotësohen prej studentëve në mënyrë anonime, kontrole paralele, kontrole vertikale prej njësisë bazë, kontrole dhe organizime të seancave të veçanta prej njësisë së zhvillimit të karrierës dhe cilësisë, kontrole dhe vlerësime kolegë me kolegë, apo raportet e vlerësimit të pedagogëve prej studentëve.</p> <p>Në kuadër të vlerësimit të jashtëm, UL në vitin 2016-2017 ka hartuar raportet e vetëvlerësimit dhe i është nënshtruar akreditimit institucional duke marrë Çertifikaten e Akreditimit për 6 vite akademike. Tashmë kjo periudhë ka përfunduar dhe institucioni është në periudhën e ri akreditimit.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të aplikimit si dhe vizita në institucion GVJ evidenton se institucioni nëpërmjet formularëve tip realizon vlerësimin e pedagogut nga studentët, vlerësimin e pedagogut nga eprori në mësimdhënie dhe kërkimin shkencor.</p> <p>Ne evidentuam Raportin e Monitorimit të Procesit Mësimor por mendojmë që ky raport duhet të ketë me shume analiza rreth treguesve të dale nga përpunimi i formularëve dhe të shpreh vlerësimin e secilit pedagog në mësimdhënie, në projekte, në punë kërkimore, në punë administrative dhe angazhime të tjera profesionale.</p> <p><i>Nuk na rezulton që UL të ketë evidentuar të meta dhe dobësi në procesin e sigurimit të mësimdhënies dhe të realizimit të gjithë programit të studimeve master.</i></p> <p><i>Evidencë nr. 12.1.Format raporti vlerësimi Pedagogu</i> <i>Evidencë nr.12.2. Format i Vlerësimit të pedagogut nga eprori</i> <i>Evidencë nr.12.3 Raporti i monitorimit të procesit mësimor.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Universiteti është i angazhuar për sigurinë dhe përmirësimin e cilësisë së brendshme të mësimdhënies, ka strukturat e posaçme që realizojnë dhe ndjekin këtë element, përdor tregues të matshëm dhe të dukshëm Megjithatë, nuk rezulton që të ketë një raport me analizë të plotë të rezultateve si dhe nuk janë evidentuar të meta dhe dobësi në programin e studimit që vlerësohet prej GVJ.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënësve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e aplikimit dhe vizitën në institucion GVJ evidentoi se institucioni përdor mekanizma formal dhe i dokumenton ato lidhur me mbikëqyrjen periodike të programit të studimit. Kjo realizohet periodikisht dy herë në vit nëpërmjet realizimit të anketimeve me studentët e programit si dhe plotësimit të formularëve nga eprori të performancës së pedagogëve.</p> <p>Ashtu siç kemi theksuar me lart GVJ nuk evidentoi analiza të dobësive apo praktikave dhe arritje të mira për motivim të stafit akademik.</p> <p><i>Evidencë nr. 12.1.Format raporti vlerësimi Pedagogu</i> <i>Evidencë nr.12.2. Format i Vlerësimit të pedagogut nga eprori</i> <i>Evidencë nr.12.3 Raporti i monitorimit të procesit mësimor</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Raporti i vlerësimit në nivel institucional i nënshtrohet analizës në strukturat përkatëse të UL. Analiza për këtë program është brenda këtij raporti institucional.</p> <p><i>Evidencë nr. 12.1.Format raporti vlerësimi Pedagogu</i> <i>Evidencë nr.12.2. Format i Vlerësimit të pedagogut nga eprori</i> <i>Evidencë nr.12.3 Raporti i monitorimit të procesit mësimor</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të</p>	<p>UL përdor si metoda të drejtpërdrejta të vlerësimit të cilësisë së programit të studimit nëpërmjet vrojtimit të orëve mësimore, kontakteve apo bisedave me studentet e programit apo edhe monitorimin e praktikës profesionale. Institucioni përdor edhe metoda indirekte të vlerësimit kryesisht nëpërmjet realizimit online të anketimit të studentëve në mënyrë anonime për të vlerësuar procesin e mësimdhënies si dhe pedagogun</p>

<p>provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p><i>Evidencë nr. 12.1.Format raporti vlerësimi Pedagogu</i> <i>Evidencë nr.12.2. Format i Vlerësimit të pedagogut nga eprori</i> <i>Evidencë nr.12.3 Raporti i monitorimit të procesit mësimor</i> <i>Vizita e GVJ në institucion</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Metodat e tërthorta të vlerësimit të programit të përdorur kanë qënë ato që kanë të bëjnë me pyetësorët realizuar me studentët, monitorimi i orëve të mësimit dhe i gjithë procesit të mësimdhënies, analiza e rezultatit të studentëve në provime, vëzhgimet e praktikave, mbikëqyrja e punimit të diplomave, etj.</p> <p>Në programin e studimit MSH në Bankat dhe Tregjet Financiare një numër studentësh janë të punësuar dhe kontaktet me punëdhënësit shërben gjithashtu si një metodë e vlerësimit të tërthortë, alternative, të programit të studimit.</p> <p><i>Evidencë nr. 12.1.Format raporti vlerësimi Pedagogu</i> <i>Evidencë nr.12.2. Format i Vlerësimit të pedagogut nga eprori</i> <i>Evidencë nr.12.3 Raporti i monitorimit të procesit mësimor</i> <i>Vizita e GVJ në institucion</i></p>			
<p>Konkluzione</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të</p>	<p>Në dokumentet e institucionit është parashikuar prezenca dhe kontributi i aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm, të interesuar për sigurimin e cilësisë dhe të përmirësimit të jashtëm të saj. Në Manualin e Sigurimit të cilësisë përcaktohet që si në NJSBC në nivel institucional ashtu edhe në GVB në nivel njësie kryesore është parashikuar që duhet të bëjnë pjesë krahas personelit akademik edhe përfaqësim nga studentët.</p>

<p>interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Prezenca e aktorëve të jashtëm ka qënë ose e papërfillshme ose e munguar në rastin e programit të studimit MSH në Bankat dhe Tregjet Financiare.</p> <p><i>Evidencë nr.17. 1. Manuali i sigurimit të cilësisë</i> <i>Evidencë nr.17.2 Strategjia e NJSBC</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Në Manuali i Sigurimit të Cilësisë dhe aktet e tjera janë të përcaktuara qartë përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për NJSB (neni 4), GVB (neni 5), njësinë kryesore, njësinë bazë dhe vete stafin akademik ne funksion të sigurimit të brendshëm të cilësisë.</p> <p>Në realitet nuk ka pasur raste të analizës dhe përcaktimit të ndonjë përgjegjësie të drejtpërdrejtë apo të deleguar për programin e studimit, përgjatë periudhës që nga fillimi i këtij programi</p> <p><i>Evidencë nr.17. 1. Manuali i sigurimit të cilësisë</i> <i>Evidencë nr.17.2 Strategjia e NJSBC</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>Në Manuali i Sigurimit të Cilësisë dhe aktet e tjera janë saktësuar përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për NJSB (neni 7) GVB (neni 8), njësinë kryesore, njësinë bazë dhe vete stafin akademik në funksion të sigurimit të brendshëm të cilësisë.</p> <p><i>Evidencë nr.17. 1. Manuali I sigurimit të cilësisë</i> <i>Evidencë nr.17.2 Strategjia e NJSBC</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Në të gjithë veprimtarinë lidhur me vlerësimin dhe analizën e ecurisë së programit të studimit, respektohet liria dhe integriteti akademik i pedagogëve, shmanget shkelja e të drejtave të individit, respektohet barazia midis stafit dhe studentëve, apo nuk është lejuar dhe nuk lejohet ndonjë shfaqje tjetër që shpreh diskriminim apo mosrespektim.</p> <p><i>Evidencë nr.17. 1. Manuali i sigurimit të cilësisë</i> <i>Evidencë nr.17.2 Strategjia e NJSBC</i> <i>Vizita e GVJ në institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Te dyja strukturat e ngritura për sigurimin e cilësisë në institucion përbehen nga staf akademik dhe një përfaqësues të studentëve .</p> <p>GVJ nuk evidentoi bashkëpunim të drejtpërdrejtë të bashkëpunëtorëve të jashtëm të marrjes se ekspertizës prej tyre. Në takimet me përfaqësues të biznesit apo me specialiste të fushës se program qe kane zhvilluar leksione të hapur është marrë një mendim i tërthortë për rritjen e cilësisë së mësimdhënies.</p> <p><i>Evidencë nr.17. 1. Manuali i sigurimit të cilësisë</i> <i>Evidencë nr.17.2 Strategjia e NJSBC</i> <i>Vizita e GVJ në institucion</i></p>

Konkluzione	<i>Institucioni ka parashikuar në dokumentet e tij kryesisht përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe pjesërisht në mënyrë të tërthortë të bashkëpunëtoreve të jashtëm në vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Veprimtaria e UL në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe politikat apo strategjitë në këtë kuadër janë të hapura, janë bërë publike në aktet kryesore të universitetit dhe publikohen në website të universitetit. <i>Evidencë nr.17. 1. Manuali i sigurimit të cilësisë</i> <i>Evidencë nr.17.2 Strategjia e NJSBC</i>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Në Manualin e Sigurimit të Cilësisë janë parashikuar parimet kryesore mbi të cilat ndërtohet sigurimi i brendshëm i cilësisë. Raportet dhe vlerësimet e realizuara nga NJSBC janë objekt diskutimi në njësinë bazë dhe për raste specifike shqyrtohen edhe me njësitë drejtuese. <i>Nuk ka raporte apo analiza që të lidhen me programin studimit</i> <i>Evidencë nr.17. 1. Manuali i sigurimit të cilësisë</i> <i>Evidencë nr.17.2 Strategjia e NJSBC</i> <i>Evidencë shtesë. Raport përmbledhës statistikor</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Departamenti i Financë Bankë si njësitë bazë që mbulon dhe drejton programin e studimit MSH në Bankat dhe tregjet Financiare, sipas rasteve angazhohen me vendime të veçanta sipas rastit të njësisë kryesore ose të rektoratit që të ndërtojnë planin e masave që synojnë plotësimin e mangësive dhe përmirësimin e situatave kur ka qënë rasti. Kjo realizohet me zhvillimin e trajnimeve të stafit në aspekte pedagogjike dhe didaktike, apo edhe pjesëmarrja nëpërmjet mobiliteteve në kuadër të programeve ERASMUS <i>Nuk ka pasur praktika dhe akte të kësaj natyre për programin që vlerësohet.</i> <i>Evidencë nr.17. 1. Manuali i sigurimit të cilësisë</i> <i>Evidencë nr.17.2 Strategjia e NJSBC</i> <i>Evidencë shtesë. Raport përmbledhës statistikor</i>

<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i programit të studimit dhe syllabusve evidentojmë se gjatë 3-4 viteve të fundit nuk është bërë ndryshim në programin mësimor brenda kufirit 20 %, por vetëm axhustime në programe të lendeve.</p> <p><i>Vizita e GVJ në institucion</i> <i>Evidencë nr.2.11, 2.12; dhe 2.13, 2. Plani mësimor 209-2022</i> <i>Evidencë nr. 2.14. Syllabuset e lendeve</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Departamenti, njësia kryesore dhe strukturat e tjera kanë organizuar dhe organizojnë herë pas here veprimtari periodike me studentët por edhe me personelin për të informuar dhe ndërgjegjësuar gjithë pjesëmarrësit lidhur me nevojën dhe domosdoshmërinë e përmirësimin të cilësisë</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në përgjithësi, veprimtaritë, analizat, proceset e ndërmarra për përmirësimin e brendshëm të cilësisë kanë qënë publike, transparente dhe të efektshme. Parimet mbi të cilat ndërtohet kjo veprimtari janë të sanksionuara në aktet e universitetit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
---	------------------------------	-------------------------------------	------------------------------------	---

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Bankat dhe Tregjet Financiare” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Shkolla e Lartë Universitare Private Luarasi”

Pikat e forta dhe afirmime

Grupi i ekspertëve të jashtëm konkludon se programi i studimit Master i Shkencave në “Bankat dhe Tregjet Financiare” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Shkolla e Lartë Universitare Private Luarasi” ka pika të forta, të tilla si:

1. “Shkolla e Lartë Universitare Private Luarasi”, njësia kryesore dhe ajo bazë që drejtojnë këtë program studimi kanë reputacion dhe imazh të mirë në vend.
2. Vendndodhja e institucionit si dhe marketingu që zhvillon ky institucion janë faktor pozitiv që e bëjnë më atraktiv në përthithjen e studentëve kandidatë të programit të studimit.
3. Studentët e këtij programi studimi janë të motivuar dhe ndiqnin me shumë interes këtë program duke pasur marrëdhënie të mira komunikimi me stafin akademik dhe ndihmës si dhe bashkëpunim të frytshëm gjatë gjithë periudhës së studimit.
4. Jeta e gjallë studentore në mjediset e brendshme të universitetit në të cilën janë përfshirë edhe studentët e programit të studimit Master i Shkencave në Bankat dhe Tregjet Financiare.
5. Universiteti ka një numër të konsiderueshëm marrëveshje bashkëpunimi dhe këmbime me universitete të tjera dhe me partner ndërkombëtarë.
6. Universiteti ka një numër të konsiderueshëm marrëveshje bashkëpunimi me institucionet financiare dhe aktore të biznesit në vend e cila është një mundësi e madhe për realizimin e praktikës profesionale pranë tyre apo punësim për të diplomuarit në këtë program studimi.
7. Një pjesë e konsiderueshme e studentëve të cilët kanë mbaruar këtë program studimi, janë të punësuar në vende pune ku i përgjigjen edhe studimeve të tyre në programin Master i Shkencave në “Bankat dhe Tregjet Financiare”.

Pika të dobëta

1. Konkurrenca e madhe nga programe master të përafërta të cilat zhvillohen në universitetet e tjera publike dhe private në vend.
2. Mos reflektim në programin mësimor të zhvillimeve në tregun financiar dhe bankar me lëndë karakterizuese të programit.
3. Programi i studimit master shkencor “Bankat dhe Tregjet Financiare”, ka një fond të limituar të botimeve dhe artikujve shkencorë në funksion të këtij program studimi.

Rekomandime

- GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se edhe pse numri i stafit akademik i angazhuar në këtë program ka qenë i qëndrueshëm, institucioni duhet të bëjë përpjekje paralele që rritja e numrit të PAE të plotësojë edhe realizimin e ngarkesës mësimore në masën mbi 70 % nga personeli akademik. Gjithashtu i gjithë stafi akademik i angazhuar në këtë program duhet të zotërojë tituj akademik dhe grada shkencore si kërkesë ligjore për mësimdhënie në një program Master Shkencor.

- GVJ bazuar në shqyrtimin e programit të studimit të aplikuar gjatë gjithë periudhës rekomandon se është e nevojshme të bëhen përmirësime në programin mësimor me qëllim reflektimin e zhvillimeve në tregun financiar e bankar duke rritur numrin e lëndëve në funksion të objektivit të tij si lëndë të tilla “*Teknika Bankare*”, “*Marketingu bankar*” etj., si dhe duke hequr lëndë të karakterit të përgjithshëm siç është lënda “*Kontabilitet Nacional*”.
- Bazuar në planën mësimore të ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E) vëmë re se të dyja lëndët e kategorisë A (përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme) nuk e kanë këtë natyrë veprimtare. Në këtë kategori janë lëndë të cilat duhet të ndodheshin në kategorinë B. Ndërsa në kategorinë B janë lëndë të cilat kanë përgatitje metodologjike e cila duhet të kalojë në kategorinë A.
- Për të rritur fleksibilitetin e programit ne mendojmë se në të duhet të përfshihen lëndë me zgjedhje që do u japë mundësi studentëve të zgjedhin lëndë të preferuara në funksion edhe të punësimit në të ardhshëm.
- Në disa nga programet e lëndëve të këtij programi studimi duhet të bëhet përditësimi i literaturës bazë pasi ende ka referime të literaturës të para 10 viteve.
- Përsa i përket praktikës në auditor, GVJ sugjeroi që këto orë praktike të zhvilloheshin me ekspertë nga tregu i punës dhe jo nga stafi akademik, si dhe vetë praktika të zhvillohet pranë institucioneve financiare apo aktorëve të biznesit.
- Strukturat e posaçme të ngritura për sigurinë dhe përmirësimin e cilësisë së brendshme të mësimdhënies, duhet të bëjnë analiza më të plota të rezultateve duke evidentuar arritjet por edhe të meta dhe dobësi në programin e studimit.
- Rekomandojmë shtimin e fondit të librave me tekste në shqip por edhe në anglisht për lëndët karakterizuese të programit, me qëllim që leksionet e parashkruar të cilat janë përgatitur nga stafi akademik, të plotësohen me këto tekste.
- Në funksion të kërkimit shkencor mendojmë se në kuadër edhe të strategjisë afatmesme të kërkimit shkencor të institucionit, ky i fundit duhet të synojë rritjen e numrit të studentëve të angazhuar në kërkimin shkencor pasi numri i tyre është i ulët dhe për më tepër nuk ka studentë të përfshirë nga ky program studimi. Gjithashtu rekomandohet edhe pjesëmarrje më të gjerë e studentëve në veprimtari shkencore të organizuara nga vetë institucioni por edhe jashtë tij.

Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Sciences in "Banks and Financial Markets" provided by the Higher Education Institution "Private University Luarasi"

Strengths and Affirmations

The group of external experts concludes that the Master of Science study program in "Banks and Financial Markets" offered by the Higher Education Institution "Private University Luarasi" has strong points, such as:

1. "Private University Luarasi" the main unit and base unit that runs this study program, has a good reputation and image in the country.
2. The institution's location and the marketing it develops are positive factors that make it more attractive in attracting candidate students for the study program.
3. The students of this study program are motivated and have pursued it with great interest, establishing good communication relations with the academic and support staff, as well as fostering fruitful cooperation throughout the study period.
4. Active student life within the university's internal environments is also accessible to the students of the Master of Science in "Banking and Financial Markets" study program.
5. The university has a significant number of cooperation agreements and exchanges with other universities and with international partners.
6. The university has a significant number of cooperation agreements with financial institutions and business actors in the country, which is a great opportunity for professional practice with them or employment for graduates of this study program.
7. A significant number of students who have completed this study program are employed in workplaces where they can apply the knowledge acquired during the Master of Science program in "Banking and Financial Markets".

Weaknesses

1. There is strong competition from similar master's programs that are offered in other public and private universities in the country.
2. There is a lack of reflection in the curriculum regarding developments in the financial and banking market, particularly with respect to the characteristic subjects of the program.
3. The scientific master's study program "Banks and Financial Markets" has a "limited" collection of publications and scientific articles relevant to this study program.

Recommendation

- Based on the review of the study program applied throughout the period, Internal Evaluation Group (IEG) recommends that it is necessary to make improvements in the curriculum to reflect developments in the financial and banking market. This can be achieved by increasing the number of subjects that align with the program's objectives, such as "Banking Techniques" and "Banking Marketing," while simultaneously considering the removal of subjects of a general nature, like "National Accounting".
- Based on the curriculum divided according to formative activities (A-E), it is evident that certain subjects within category A (methodological preparation and general culture) do not align appropriately with the nature of this activity. Some of these subjects should have been placed in category B. Conversely, within category B, there are subjects that possess methodological preparation and should instead be transferred to category A.
- To enhance the program's flexibility, we propose the inclusion of optional subjects that will empower students to select their preferred courses based on their career aspirations and future employment prospects.
- In some of the subject programs within this study program, the foundational literature requires updating, as certain references still pertain to literature from a decade ago.
- Regarding the practice in the auditorium, IEG suggests that these practical hours should be conducted with experts from the labor market rather than the academic staff. Furthermore, it is recommended that the practice be carried out in close proximity to financial institutions or business entities.
- The special structures established for the safety and enhancement of the internal teaching quality should conduct a more comprehensive analysis of the results, emphasizing both the achievements and the flaws and weaknesses within the study program.
- We recommend incorporating books with texts in both Albanian and English languages for the characteristic subjects of the program. This addition aims to complement the prescribed lectures provided by the academic staff with additional reference materials.
- In terms of scientific research, we propose that the institution's medium-term scientific research strategy should strive to augment the involvement of students in research endeavors, as their current participation is relatively low. Additionally, it is crucial to address the absence of students engaged in research within this study program. To achieve this, we recommend encouraging wider participation of students in scientific activities organized both by the institution itself and external entities.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Plotësisht përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X